# RAPORTI

# I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

# TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

## Bachelor në Administrim Biznesi

## SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE

## "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"

**TIRANË, 2015**

**PËRMBAJTJA**


| Nr. | Përshkrimi | Faqe |
|---|---|---|
| I. | **HYRJE** | 4 |
| | **INFORMACIONI KRYESOR PËR *SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"* DHE PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE TË OFRUARA PREJ SAJ** | 6 |
| II. | **REZULTATE TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM** | 19 |
| | a. Ofrimi i programeve të studimeve<br>b. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i institucionit në përputhje me nevojat e programeve të studimeve<br>c. Personeli i institucionit të arsimit të lartë, programeve<br>d. Mbrojtja e të drejtave të studentëve<br>e. Shërbimet e institucionit në dispozicion të studentëve. Biblioteka dhe burime të tjera informacioni<br>f. Burimet financiare dhe menaxhimi i tyre<br>g. Marrëdhëniet e bashkëpunimit<br>h. Garantimi i sigurimit të cilësisë | |
| III. | **ANALIZA SWOT** | 71 |

**SHKURTIME**

| | |
|---|---|
| **APAAL** | Agjencia Publike e Akredimit të Arsimit të Lartë |
| **GVB** | Grupi i Vlerësimit të Brendshëm |
| **LAL** | Ligji për Arsimin e Lartë |
| **MAS** | Ministria e Arsimit dhe Sportit |
| **DNP** | Diplomë e Nivelit të Parë |
| **NJSBC** | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |
| **SHLUJ** | Shkolla e Lartë Universitare Jopublike |
| **UMB** | Universiteti Marin Barleti |

**HYRJE**

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor” në Administrim Biznesi, sistemi me kohë të plotë dhe të pjeshme, në *Shkolla e Lartë Universitare Private “Universiteti Marin Barleti”* në Tiranë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm, i ngritur mbi bazë të urdhrit të Rektorit të UMB-së nr. 32, datë 09.01.2014.

Përbërja GVB:

1. Dr. Semiha LOCA - Kryetare
2. Msc. Jorida TARAJ, Anëtare- Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm
3. Msc. Andi Gjokutaj, Anëtar- Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike
4. Kleopatra Puraveli, Anëtare – Kryesekretare
5. Desara Doçi, Anëtar – ish studente, Dega Administrim Biznesi
6. Mirjan Petro, Anëtar – ish studente, Dega Informatikë e Aplikuar

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues real dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit.

Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB iu nënshtrua një trajnimi paraprak nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për studimet Bachelor pranë UMB-së, mbi bazë të eksperiencës së vlerësimeve të mëparshme. Trajnimi u fokusua në standardet e kërkuara për këtë vlerësim, procedurat dhe instrumentet përkatës, dokumentet mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi, duke ju ofruar dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e programit të studimit në Bachelor Administrim Biznesi që kërkohej të kryhej prej tyre.

Më tej, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së SHLUJ UMB bëri një plan pune, ndau detyrat dhe udhëzoi secilin anëtar të grupit të vlerësimit për përmbushjen e detyrave.

Për hartimin e këtij raporti, GVB organizoi takime me stafin akademik, administrativ, atë mbështetës si dhe me studentët. Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat që kishte SHLUJ UMB, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën.

Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit “Bachelor” në Administrim Biznesi, në *Shkolla e Lartë Universitare Private “Universiteti Marin Barleti”*, Tiranë, është:

1) Ligji nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.9832, datë 12.11.2007, i ndryshuar me ligjin nr. 10037, datë 22.7.2010, i ndryshuar me ligjin nr. 10493, datë 15.12.2011;

2) Standardet për akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të parë, miratuar me Urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, nr. 134, datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të parë të Institucioneve të Arsimit të lartë";

3) Udhëzimet e MAS (ish MASH);

4) Rekomandimet e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë dhe në "Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë";

5) Dokumente të veprimtarisë institucionale të *Shkolla e Lartë Universitare Private "Universiteti Marin Barleti"*, më konkretisht:
   - Statuti i SHLUJ UMB,
   - Rregullore e SHLUJ UMB,
   - Rregullore e Programit
   - Rregullore e tansferimeve
   - Manuali i stafit Akademik

6) Dokumentacioni pedagogjik, më konkretisht:
   a. Programi i Studimit Bachelor – Administrim Biznesi,
   b. Planet mësimore,
   c. Syllabus-e të lëndëve,

7) Të dhëna të gjeneruar nga baza e të dhënave e SHLUJ UMB, më konkretisht:
   - Baza e të dhënave për programin e studimit;
   - Baza e të dhënave për studentët;
   - Baza e të dhënave për personelin pedagogjik dhe administrativ;
   - Baza e të dhënave për infrastrukturën;
   - Punime të studentëve;
   - Formularë të vlerësimit të studentëve për mësimdhënien;
   - Takime me drejtues, pedagogë, studentë;
   - Raporte të vlerësimit të Njësisë së sigurimit të cilësisë në SHLUJ UMB UMB;
   - Informacione në lidhje me veprimtari shkencore ku janë përfshirë studentët;
   - Raporte te punës kërkimore shkencore;
   - Raporte vjetore mbi veprimtarinë e SHLUJ UMB.

## II. INFORMACIONI KRYESOR PËR *SHKOLLA E LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "UNIVERSITETI MARIN BARLETI"*

### 2.1. Baza ligjore për programet e studimeve të ofruara prej saj

SHLUJ UMB është **institucion privat (jopublik) i arsimit të lartë**, i krijuar në bazë të Ligjit nr. 8461, datë 25.02.1999, i ndryshuar, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe funksionon në bazë të Ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007, nr. 10307, datë 22.7.2010, Nr. 10493, datë 15.12.2011 dhe aktet nënligjore të dala në bazë të tij.

SHLUJ UMB ka filluar aktivitetin e saj në vitin 2005 mbi bazën e VKM nr. *571, dt. 12.08.2005 "Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare private Marin Barleti"*, me dy fakultete dhe pesë degë: Fakulteti i gjuhëve të huaja me degët gjuhë angleze, gjuhë gjermane dhe gjuhë frënge dhe Fakulteti i matematikës së zbatuar me degët matematikë - administrim dhe matematikë - financë. Në datë 12.04.2006, me vendimin me nr. 2365, Ministria e Arsimit dhe Shkencës miratoi hapjen pranë SHLUJ Universiteti "Marin Barleti" edhe të dy fakulteteve të reja me gjashtë degë: Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit me degët *menaxhim-biznes dhe financë-kontabilitet dhe* Fakultetit të Shkencave Humane *me degët psikologji, shkenca politike, sociologji dhe psikologji*.

Me VKM nr. 96, dt. 27.01.2009 "*Për hapjen programeve të studimit të ciklit të dytë në shkollën e lartë universitare private "Universiteti Marin Barleti",* Këshilli i Ministrave miratoi hapjen e programeve të studimit Master i Nivelit të Parë (MNP) në 11 drejtime (marketing & menaxhim operacionesh, shërbime bankare dhe financiare, pasuri të patundshme dhe sigurime, financë-kontabilitet, lidership dhe menaxhim burimesh njerëzore, administrim publik, lidership, e drejta publike, e drejta e biznesit, komunikim publik dhe gazetari ekonomike).

Me VKM nr. 564 datë 28.05.2009 "*Për hapjen e programeve të reja të studimit "Master i Nivelit të Dytë", pranë Shkollës së Lartë Universitare Private "Universiteti Marin Barleti",* Këshilli i Ministrave miratoi hapjen e programeve të studimit Master i Nivelit të Dytë (MND) në fushat Shkenca politike (profilet *Lidership, Administrim Publik*); Komunikim (profilet Gazetari Ekonomike, Komunikim publik); Administrim Biznesi (profilet Financë-kontabilitet, Marketing & Menaxhim operacionesh, Shërbime Bankare & Financiare, Prona të paluajtshme & Sigurime, Lidership & Menaxhim Burime Njerëzore); Shkenca juridike (profilet E drejtë Publike, E drejtë Biznesi).

Me urdhrin nr. 288 datë 4.09.2009 të Ministrit të Arsimit Shkolla e Lartë Universitare "Universiteti Marin Barleti" ka marrë **akreditimin pozitiv të Institucionit dhe për**

**programet e studimit** *Menaxhim Biznesi (DNP), Financë-Kontabilitet (DNP), Shkenca Politike (DNP) dhe Psikologji (DIND).*

Me urdhrin nr. 549 datë 11.11.2011, të Ministrit të Arsimit "*Për hapjen e programeve të reja të studimit dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë* Shkollës së Lartë Universitare "Universiteti Marin Barleti" është miratuar hapja e programeve: Programi i studimit i ciklit të parë Administrim Biznesi, Informatikë Aplikuar; Master i shkencave në Menaxhim Biznesi me profile: Logjistikë dhe Menaxhim Operacionesh, Marketing Strategjik, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Menaxhim i Sistemeve të Informacionit; Master i shkencave në Financë Kontabilitet me profile: Menaxhim Financiar, Shërbime Bankare dhe Financiare, Taksimi dhe Ligji, Kontabilitet; Master i shkencave në Komunikim me profile: Studime në gazetari, Komunimim/Studime në Gazetari Ndërkombëtare, Marrëdhënie me publikun në nivel ndërkombëtar; Master i shkencave në Studime Europiane me profile: Marrëdhënie ndërkombëtare e Diplomaci, Politikat Europiane dhe Administrim Publik, Studime ekonomike Europiane, E drejtë Europiane; Master i shkencave në Administrim publik me profile: Administrativ-Ligjor, Administrativ-Ekonomik; Master i shkencave në Shkenca Juridike me profile: E drejtë Publike, E drejtë penale dhe Kriminologji, E drejtë tregtare, E drejtë e pronësisë Intelektuale; Master Profesional në Edukim me profile: Mësimdhënia e të nxënit, Administrim i arsimit.

Me urdhrin nr. 19 datë 19.01.2012, të Ministrit të Arsimit është miratuar *Hapja e programit të studimit të ciklit të tretë të doktoratës në "Studime Ndërkombëtare për familjen dhe komunitetin" të Universitetit Clemson, pranë Shkollës së lartë Universitare private Marin Barleti*.

Me urdhrin nr. 329 datë 07.08.2012 të Ministrit të Arsimit është miratuar**: Akreditimi** i i Programit të ciklit të dytë Master Profesional në Shkenca Politike me profil: Administrim Publik; Master Profesional në Shkenca Juridike me profile: E drejtë Publike, E drejtë Biznesi; Master profesional në Administrim Biznesi me profile: Shërbime bankare e financiare, Marketing dhe Menaxhim Operacionesh, Lidership dhe Menaxhim Burime Njerëzore, Financë-Kontabilitet.

Me urdhrin nr. 535 datë 07.11.2012, të Ministrit të Arsimit "*Për hapjen e programeve të reja të studimit Bachelor dhe fillimin e veprimtarisë akademike për këto programe, pranë* Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike "Universiteti Marin Barleti" është miratuar hapja e programit të studimit të Ciklit të Parë në Edukim fizik e Sporte, si dhe dy programe studimi të Ciklit të Dytë, me 60 kredite: Master profesional në Sociologji Zhvillimi me profile *Zhvillimi social komunitar* dhe *Zhvillim ekonomik dhe studim tregu* si dhe Master profesional në Psikologji Ligjore.

Me urdhrin nr. 337 datë 16.08.2013 të Ministrit të Arsimit Shkolla e Lartë Universitare "Universiteti Marin Barleti" ka marrë **akreditimin pozitiv për programet e studimit** *Bachelor në Drejtësi, Bachelor në Psikologji, Bachelor në Sociologji.*

Me Urdhrin e Ministrit të MAS Nr. 394, datë 6.10.2014 është miratuar hpja e programeve: Msc në Sociologji Zhvillimi Komunitar; Bachelor në Inxhinieri Sistemesh dhe Programesh Kompjuterike me profile: -*Inxhinieri softuerike -Menaxhim i databazave-Multimedia dizajn dhe zhvillim-Komunikim dixhital-Inxhinieri rrjeti;* MP në Menaxhim Transporti dhe Logjistikë; MP në Projektues në Arkitekturë të qëndrueshme; MP në Arkitekturë Interieri; MP në Arkitekturë Industriale; MP në Peisazh i Territorit Urbanistik Logjistik; Master shkencor - Program Studimi i Integruar i Ciklit të Dytë në "Arkitekturë; Bachelor në - *Financë, Banka, Sigurime;* Bachelor në - *Kontabilitet, Auditim, Taksa.*

## 2.2. Vizioni, Misioni dhe Zhvillimi strategjik i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Marin Barleti"

SHLUJ UMB ka zhvilluar projektin e vet strategjik në sfondin e veprimtarisë kombëtare në arsim për zgjerimin e demokratizimit dhe reformës institucionale me vështrim ndaj modernizimit dhe pranimit të plotë në Evropë. Ai pohon përparësitë e forcimit të qytetarisë, zhvillimin dhe mobilizimin e njohurive, si dhe rëndësinë e angazhimit në tregjet e reja për të siguruar konvergjencën e ekonomisë shqiptare në tranzicion.

Në kontekstin shqiptar, SHLUJ UMB dallohet për sa i përket synimit për të kombinuar principet e shkollës liberale klasike me idealet e tij për opinion të pavarur kritik dhe mendimin e lirë, me cilësitë themelore të mendjes dhe shpirtin e sipërmarrësit, që mund të shfrytëzohen për të nxitur përparime personale dhe profesionale, si dhe duke parë e duke iu afruar botës në një mënyrë që vërtet ndihmon të tjerët. Duke ofruar degë dhe profile, duke përfshirë stazh dhe përvojë praktike pune në industri dhe tregti, diplomat e SHLUJ UMB kombinojnë sfidën akademike me trajnimin dhe aftësitë që do t'i pajisin studentët për punësim në të ardhmen, si dhe t'i lejojnë ata të jenë ambasadorë të fuqishëm për Shqipërinë në shoqërinë evropiane e më gjerë.

SHLUJ UMB operon si një institucion i pavarur i arsimit të lartë. Si i tillë, ai është i paangazhuar politikisht dhe synon të punojë për të mirën e shoqërisë në disa mënyra të ndërlidhura:
- si një mjet për përftimin e njohurive dhe krijimin e kapitalit të qëndrueshëm intelektual;
- si një mik kritik me kapacitet akademik i qeverisjeve, për të vlerësuar dhe udhëzuar politikën;
- si një burim për gjenerimin dhe mbështetjen e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik;
- si një burim për kultivimin e idealeve dhe vlerave demokratike.

***Vizioni*** i SHLUJ UMB është që të shndërrohet në një universitet të nivelit të lartë duke bashkuar edukimin demokratik dhe liberal me shpirtin e sipërmarrjes në gjithçka që bëjmë. Ne synojmë të mendojmë globalisht duke kultivuar vetëdijen ndërkombëtare dhe duke nxitur një kulturë të re dhe krijuese të nxënies. Ne jemi njësoj të angazhuar të veprojmë si

brenda vendit, ashtu edhe sipas nevojave rajonale për të mbrojtur një të ardhme të qëndrueshme duke ndihmuar për një ekonomi më të përparuar dhe një shoqëri më të drejtë, që i nxit njerëzit të realizojnë qëllimet e tyre.

***Misioni*** i SHLUJ UMB është forcimi i trashëgimisë dhe reputacionit në drejtim të përpjekjeve shkencore për të krijuar një model të arsimit të lartë që kombinon standardet akademike me aplikimet e botës reale. Ne punojmë të jemi një institucion proaktiv me vështrim nga e ardhmja, që u përgjigjet shpresave për ndryshim, modeleve të nxënies dhe mundësive për shkëmbimin e dijes në frymë bashkëpunimi. Të udhëhequr nga vlerat dhe të përqendruar te njerëzit, do të përdorim njohuritë që krijojmë për të ndryshuar perspektivat e jetës së brezave të studentëve, duke kontribuar kështu për një shoqëri produktive dhe të begatë. Këtë do ta arrijmë duke paraqitur një ofertë akademike elastike dhe të mbështetur nga epërsia në mësimdhënie dhe nxënie, duke krijuar një përvojë aktive të studentëve, kërkim shkencor të aplikuar me njohje dhe ndikim brenda vendit, shërbime me vështrim ndaj biznesit dhe sipërmarrjes, duke luajtur një rol kyç në zhvillimin e rrjeteve që mbështesin lidhjet ndërkombëtare përmes partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë.

***Synimet dhe objektivat***

SHLUJ UMB ka një strategji disavjeçare për përparimin e synimeve dhe qëllimeve të mishëruara në vizionin dhe misionin e saj dhe e pozicionon veten si një institucion i përparuar i arsimit të lartë në rajonin e Evropës Juglindore. Strategjia përfshin gjerësisht ndjekjen e temave kryesore me rëndësi strategjike për sukses në të ardhmen. Këto tema strategjike identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë ambiciesh të ndërlidhura.

*Ambicia 1 - KULTURA*

Të krijohet një kulturë akademike e besueshme, që sigurohet përmes një bashkëpunimi dhe partneriteti ku vlerësohen larmia, krijimtaria dhe risia, ku ushqehen dhe përhapen idetë dhe ku shpërblehen rezultatet.

*Ambicia 2 – STUDENTËT*

Të përhapet një përvojë studentore e shquar, duke formuar studentë universitarë dhe pasuniversitarë që janë ambiciozë, të pavarur, studiues me iniciativë, të përgatitur mirë përmes përvojës së tyre për të mësuar nga jeta, nga realitetet e sferës së profesionit dhe nga mundësitë që sjell europianizimi.

*Ambicia 3 – PUNA KËRKIMORE*

Të mbështetet dhe të çohet më tej puna kërkimore e një standardi më të lartë në fushat kyçe me ndikim në shoqëri dhe në ekonomi, të promovohet bashkëpunimi në punën kërkimore, të inkurajohen dhe të përkrahen kërkimet e reja në mësimdhënie dhe nxënie dhe të nxitet shpirti i kërkimit dhe komunikimit.

*Ambicia 4 – RAJONI*
Të jetë forcë akademike drejtuese brenda Shqipërisë dhe më gjerë në rajonin e Evropës Juglindore, duke ndikuar për një ekonomi që shikon nga e ardhmja, që bazohet në dije të qëndrueshme dhe duke promovuar një shoqëri qytetarësh mendjemprehtë, të aftë dhe plot jetë.

*Ambicia 5 – NDËRKOMBËTARIZIMI*
Të rriten mundësitë, emri dhe reputacioni ynë përmes ndërkombëtarizimit – procesit të integrimit të një dimensioni ndërkombëtar, ndërkulturor dhe global në qëllimet, funksionet dhe përhapjen e arsimit të lartë – duke zhvilluar kështu kulturën tonë krahas asaj ndërkombëtare, duke çuar përpara europianizimin dhe duke siguruar kapacitete më të mëdha për angazhim global.

*Ambicia 6 – QËNDRUESHMËRIA*
Të përsoset më tej ekspertiza në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të përfshihen aktivitete për edukimin e qëndrueshëm në kurrikulën e universitetit, duke siguruar që të diplomuarit tanë të jenë të mirë-arsimuar dhe të vetëdijshëm për çështjet mjedisore, sociale dhe etike.

*Ambicia 7 – PROFESIONALIZMI NË SIPËRMARRJE*
Të edukojë dhe të mbështesë tek të gjithë të diplomuarit shpirtin e sipërmarrjes dhe aftësinë për të shfrytëzuar teknologjinë e re, të nxisë perspektivat e komunitetit të biznesit dhe të ofrojë edukim dhe trajnim mbi bazën e përvojës, që i pajisin praktikantët profesionistë me dijet dhe aftësitë që iu nevojiten për të përparuar profesionalisht, t'u sjellin dobi të tjerëve dhe të krijojnë mundësi të reja.

*Ambicia 8 – SIPËRMARRJA SHOQËRORE*
Të kooperohet me partnerët kryesorë për zhvillimin e përgjegjësisë shoqërore përmes aktiviteteve sipërmarrëse shoqërore dhe korrekte moralisht, duke çuar përpara punën tonë në komunitet dhe duke promovuar një veprimtari aktive të re, që siguron përfshirjen e shoqërisë.

*Ambicia 9 - INFRASTRUKTURA*
Të sigurohet që të gjitha strategjitë, politikat dhe sistemet të mundësojnë dhe të përshpejtojnë angazhimin tonë për të qenë një universitet i transformimeve dhe që krijon struktura të përgjegjshme dhe elastike, të cilat shfrytëzojnë plotësisht teknologjitë e reja dhe përkrahin ndryshimin pozitiv.

SHLUJ UMB ka përcaktuar planin e vet të zhvillimit. Në kuadrin e këtij plani synohet:

*A. Në aspektin akademik*

Të zhvillohet më tej:

- *Shkolla e Sociologjisë, Psikologjisë dhe Edukimit* duke ofruar programe të reja në pëputhje me kërkesat e tregut të sotëm, veçanërisht duke u zgjeruar akoma më tej në nivelin pasuniversitar;
- *Shkolla e Politikës, Qeverisjes dhe Komunikimi*t duke zgjeruar, ndër të tjera, lidhjet e saj ndërkombëtare, partneritetin dhe kooperimin strategjik;
- *Shkolla e Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit (Informatikë)* me oferta shtesë në aplikimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit.
- Dhe të zgjerohet më tej *Shkolla e Biznesit, Menaxhimit dhe Turizmit* me një shtesë departamentesh dhe bërjen aktive të programeve profesionale.
- Të zgjerohet *Shkolla e Inxhinierisë* dhe *Shkolla e Arkitekturës, Ndërtimit dhe Planifikimit*.

Aktualisht një pjesë e tyre funksionojnë në bazë departamentesh por me synim rritjen e numrit të studentëve dhe zhvillimin e mëtejshëm të SHLUJ UMB do të shkohet drejt krijimit të shkollave përkatëse.

*B. Në aspektin kërkimor*

SHLUJ UMB synon të krijojë dhe të mbështesë një profil kërkimor cilësor që arrin të njihet dhe të dallohet përmes inovacionit ndërdisiplinor të integruar, i përshtatshëm dhe i zbatueshëm në kontekstin rajonal. Për këtë arsye, strategjia kërkimore e universitetit përvijohet në pesë objektivat e ndërlidhura:

- Të vazhdojë rritja e kapaciteteve dhe aftësive kërkimore dhe të zhvillohet një infrastrukturë efektive për këtë qëllim.
- Të vazhdojë zhvillimi i një mjedisi dhe kulture kërkimore të qëndrueshme dhe të dobishme për studentët dhe stafin.
- Të vazhdojë zhvillimi i bashkëpunimit strategjik në punën kërkimore, në kooperim me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe qendra të shquara kërkimore që kanë interesa dhe qëllime të përbashkëta.
- Të përmbushen kërkesat e certifikatave të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare, që vërtetojnë cilësinë dhe ndikimin e përpjekjeve kërkimore.
- Të sigurohen lidhje dhe bashkëveprime efektive ndërmjet veprimtarive kërkimore, sipërmarrëse dhe të mësimdhënies.

*C. Administrim*

SHLUJ UMB ka krijuar tashmë *Akademinë Profesionale "Barleti" (BPA)* si një organizatë me shumë tipare për të gjitha aktivitetet e veta të mësimdhënies, trajnimit dhe formimit të vazhdueshëm profesional. BPA do të thellojë më tej koordinimin e studimeve të duhura

profesionale dhe të aplikuara universitare dhe pasuniversitare, TVET, shërbimet e testimit dhe programet e trajnimit dhe formimit të vazhdueshëm profesional, si dhe do të lidhet nga afër me organizma profesionale, shoqata dhe punëdhënës.

*D. Sipërmarrje*
SHLUJ UMB do të nisë *Sipërmarrjen "Barleti" sh.a.* si degën e vet të shërbimit, që ofron një sërë produktesh, shërbimesh, aktivitetesh komerciale dhe organizime ngjarjesh. Ajo do të lidhet në rrjet me degë të tjera të grupit "Dudaj" për të fuqizuar infrastrukturën plotësuese dhe për t'i siguruar kapacitet plotësues aktivitetit sipërmarrës.

*Plani i zhvillimit afatmesëm 5-vjeçar*
Në plotësimin e vizionit dhe misionit të vet, duke iu referuar veçanërisht realizimit të ambicieve strategjike për profesionalizëm në sipërmarrje dhe për ndërmarrje shoqërore, SHLUJ UMB ka nisur disa projekte strategjike që do ta çojnë edhe më përpara aftësinë e saj infrastrukturore për të qenë një institucion transformues i arsimit të lartë që plotëson lidhjen mes kërkimit, sipërmarrjes dhe inovacionit. Si pjesë të një projekti ambicioz zhvillimi, që përfshin një godinë moderne në universiteti është në prag finalizimi të projektit *Barleti Vistas TechnoPark*. Brenda këtij projekti pëfshihet dhe projekti Smart City i cili ka filluar të implementohet. Duke parashikuar një "urë ndërmjet universitetit dhe botës reale", është menduar që ai të pasqyrojë një qendër për zhvillimin e biznesit dhe do të përfaqësojë inkubatorin ( gjithashtu në fazat e para të implementimit) e parë sipërmarrës për biznesin e teknologjisë së lartë në Shqipëri, The Business Start-Up & Incubator Centre (BSIC).

### 2.3. Struktura e SHLUJ UMB

Në strukturën e SHLUJ UMB përfshihen dy fakultete, tre institute si dhe tre qendra. Struktura e universitetit përbëhet nga një matricë me dy ndarje akademike që integrojnë funksione akademike, kërkimore, administrative dhe sipërmarrëse, për të krijuar platforma të përbëra për një sërë veprimtarish dhe shërbimesh që mbështesin misionin e universitetit. Njëra ndarje fokusohet gjerësisht në shkencat sociale e humane dhe tjetra në shkencat e aplikuara dhe ekonomike.

**FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMISË** ka si qëllim të thellojë dijet tek studentët, nëpërmjet cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe punës kërkimore në fushat e finances, ekonomiksit, menaxhim biznesit, arkitekturës, turizmit dhe sektorëve të teknologjisë së informacionit. Ky fakultet është i orientuar ndërkombëtarisht, respekton ndryshimet në ambicie e talent dhe punon ngushtë me bizneset, kompanitë IT dhe arkitektë profesionistë

Misioni i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë është promovimi dhe avancimi i njohurive profesionale e praktike, si dhe i një etike të veçantë në angazhimin që

mbështet zhvillimin e kapaciteteve kolektive të nevojshme për të nxitur mirëqenien e koorporatave.

Fakulteti ofron një kurrikulum të plotë, duke përfshire jo vetem tema teknike por dhe njohuri të tjera bazë duke bërë të mundur që studentët të mësojnë një gamë të gjërë lëndësh nga teoria në aplikimin e tyre në praktikë. Fakulteti përkushtohet për ti përgatitur studentët me njohuri të nevojshme për arritur një karrierë profesionale në të ardhmen. Fakulteti ofron për të rinjtë që dëshirojnë të jenë të sukseshëm një mjedis optimal për të zhvilluar aftësitë e tyre në studim. Fakulteti zotëron një staf pedagogjik të përbërë nga profesorë të shquar të fushës ndër më të përgatitur në disiplinat përkatëse.

Vizioni i fakultetit është që të jetë një pionier udhëheqës i njohur kombëtarisht në fushën e arsimit dhe trajnimit profesional për praktikantë në sektorët e menaxhimit e biznesit, ekonomisë dhe finances, arkitekturës dhe teknologjisë së informacionit dhe të ketë rol e ndikim në rajon.

Ai do të përqendrohet në trajnim dhe ekspertizë përmes mobilizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të pjesëmarrësve për t'u angazhuar në trekëndëshin arsim, kërkim dhe inovacion, duke inkurajuar shkëmbimin eideve dhe bashkëpunimin midis studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe komunitetit të biznesit.

Fakulteti është i organizuar në tre departamente:

**Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike:** Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike siguron arsimimin e lartë dhe kërkimin shkencor në fushën e arkitekturës, urbanistikës, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit. Departamenti përmes kurrikulës së tij ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri akademike të kompetencave kryesore të formimit profesional dhe të ballafaqimit me kompleksitetin dhe transformimet e vazhdueshme të qytetit, territorit dhe peisazhit bashkëkohore. Realizimi i një pjese të madhe të punës grafike, analitike bëhet nëpërmjet aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kombinimi i trajnimeve të arsimit bazë me praktikat në terren, studiot arkitekturore, IT dhe kompanive të projektimit, do të rrisë aftësitë profesionale dhe mundësitë e punësimit.

**Departamenti i Biznes, Menaxhim dhe Turizëm:** Zhvillimi dinamik i biznesit dhe stukturimi i tij në një kontekst gjithnjë e më konkurrues kërkon edukimin e një elite të re të punonjësve dhe menaxhereve të ardhshëm, njohuritë dhe aftësitë e të cilëve, do të garantojnë konkurrueshmëri me efikasitet dhe sukses në tregjet vendase apo ndërkombëtare.

**Departamenti i Ekonomisë dhe Financës:** Departamenti i Ekonomisë dhe Financës prezantohet me një program të plotë studimesh universitare që synon të përgatisë specialistë për një karrierë të ardhshme si ekspertë kontabël, financierë, apo analistë

financash të institucioneve të ndryshme private apo publike, të tillë që në të ardhmen të mund të thellojnë studimet apo të specializohen për financat e shtetit, për bursën, për tregjet e sigurimeve etj.

**FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE SOCIALE E POLITIKE** ka si synim të përgatisë profesionistë në gjendje për të analizuar procese të rëndësishme në nivel individual e kolektiv në fushat si drejtësia, shkencat sociale e politike. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, dhe Departamenti i Shkencave Politike.

Objektivat akademike dhe shkencore të mirëpërcaktuara dhe të ndara sipas strukturave përgjegjëse të këtij fakulteti, janë në përputhje të plotë me kërkesat më të reja për modernizimin e mësimdhënies në arsimin e lartë, duke ruajtur specifikat në fushën e drejtësisë, shkencave sociale, shkencave politike dhe edukimit fizik dhe sporteve.

Programet mësimore në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike janë konceptuar dhe mbështetur në përvojat e suksesshme të universiteteve perëndimore, duke synuar krijimin e një profili të qartë dhe të dallueshëm në përshtatje me kushtet dhe zhvillimet e vendit. Fakulteti synon gjithashtu që kërkimi të bëhet një nga karakteristikat dalluese të identitetit të tij. Ai promovon kërkime dhe studime krahasuese, shumëdisiplinore në fushat e drejtësisë, politikës, qeverisjes, administrimit publik, sociologjisë, psikologjisë dhe edukimit, duke angazhuar në këtë veprimtari edhe studentët. Fakulteti ka krijuar edhe rrjetin e vet të bashkëpunimit akademik e kërkimor dhe synon ta forcojë dhe zgjerojë më tej këtë rrjet, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, duke qenë pjesë aktive e disa projekteve që lehtësojnë bashkëpunimin në këto nivele.

Fakulteti është i organizuar në tre departamente:

**Departamenti i Drejtësisë:** Departamenti i Drejtësisë promovon dhe koordinon kërkime në fushat shkencore juridike duke qënë kështu pika e kontaktit në raport më aktivitetet kërkimore të realizuara nga fusha të përafërta. Në të njëjtën kohë Departamenti krijon marrëdhënie me Departamentet e tjerë të Fakultetit dhe me Institute ndëruniversitare siç është Instituti i Cështjeve Publike me qëllim organizimin dhe forcimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

**Departamenti i Shkencave Politike:** Programi i studimit në Shkenca Politike, i konceptuar në përputhje me Deklaratën e Bolonjës, mundësojnë një përgatitje cilësore të studentit në disiplina si politologji, histori, filozofi, etj. Gjithashtu ai ofron mjetet analitike, metodologjike dhe konceptuale për interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve që rrjedhin nga procesi i europianizimit dhe globalizimit; zhvillon aftësi kërkimore në fushat shoqërore dhe përgatit studentin të reflektojë mbi dukuri që lidhen me dimensionet politike.

**Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit:** Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit përbëhet nga tre njësi didaktike: njësia e Sociologjisë, njësia e Psikologjisë dhe njësia e Edukimit. Departamenti realizon programe studimi në nivelin bachelor, në Sociologji, Psikologji dhe Edukim Fizik e Sporte. Ky formim i aftëson studentët si profesionistë për të përballuar kërkesat e tregut të punës në një shoqëri të hapur dhe gjithnjë e më të integruar, si dhe i plotëson ata për të qenë qytetarë aktivë të një shoqërie të re demokratike.

Përmbushja e objektivave si dhe planeve afatmesme e aftagjata te SHLUJ "Universiteti Marin Barleti"mbështetet nga institutet dhe qendrat kërkimore të themeluara prej tij.

Instituti i Edukimit Barleti: Vizioni i Institutit të Edukimit (IE) është që të krijojë një sistem bashkëpunimi profesional, të frytshëm dhe funksional midis fakulteteve të universitetit "Marin Barleti", i cili identifikon vazhdimisht nevojat për përmirësim të cilësisë së shërbimit që ofrohet në procesin mësimor, si dhe nxit veprimtarinë kërkimore.

Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti": Misioni i Institutit të Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" në veçanti është studimi dhe kërkimi shkencor i mbështetur në traditën e hershme të studiuesve tanë, nën shembullin e qytetërimeve të suksesshme bashkëkohore.

Instituti Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA) është njësi e orientuar kryesisht për studimin e politikave dhe është ngritur mbi një kuadër ndërdisiplinor, që përbëhet nga shkencat shoqërore, studimet ligjore dhe mjedisore.

Qendra e Trajnimit dhe Testimi Barleti: Qendra e Trajnimit dhe Testimit Barleti (BTTC) funksionon si një njësi e koordinimit organizativ, e administruar krejtësisht nga UMB , dhe krijon një platformë shërbimi për një sërë ofertash trajnimi dhe testimi të dalluara në rang ndërkombëtar.

Institute for Smart and Creative Development: Adriapol Institute for Smart and Creative Development është një organizatë që ka si qëllim të saj primar krijimin e një qyteti "aktiv" dhe tërheqës ku kreativiteti dhe inovacionit janë motoja për çdo ditë të jetës.

**Organet drejtuese të SHLUJ UMB-së janë:**

- *Bordi Drejtues* është organ qeverisës i universitetit, njeh mirëqeverisjen si sistem dhe proces që lidhet *me drejtimin e përgjithshëm, efektivitetin, mbikëqyrjen dhe kontabilitetin e një organizate.* Bordi është krijuar për të mbikëqyrur ecurinë e universitetit dhe për të promovuar sukseset e tij. Anëtarët e tij janë figura të rëndësishme aktive në shoqërinë shqiptare dhe shumica e tyre kanë profil ndërkombëtar. Bordi është ngarkuar të veprojë në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ta ushtrojë pushtetin e vet vetëm për qëllimet për të cilat ky pushtet i është akorduar. Individualisht ose kolektivisht, anëtarët e Bordit japin gjykime të pavarura në interes të universitetit, si dhe tregojnë kujdes të arsyeshëm, maturi financiare, aftësi dhe zell në interes të aksionerëve dhe palëve të interesuara të universitetit.

- *Rektorati* vepron nën udhëheqjen e rektorit të universitetit, i cili ka përgjegjësinë për drejtimin e përditshëm të universitetit, si dhe për të siguruar se ka një menaxhim efektiv dhe kontroll të standardeve akademike, përvojës së studentëve dhe zhvillimit institucional. Rektorati përfshin zyrat e prorektorit për çështjet akademike, prorektorit për kërkimin, prorektorit për çështjet studentore dhe administratorit të deleguar.
- *Senati akademik* është organ kolegjial vendimmarrës, që përcakton politikat e zhvillimit të institucionit, programon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë e mësimdhënies e të kërkimit shkencor dhe vlerëson efikasitetin e tyre.
- *Këshilli i Fakultetit* është organ kolegjial vendimmarrës, që programon e përcakton, në bazë të propozimeve të departamenteve, përdorimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion të fakultetit. Ai propozon për programe të reja studimi ose të kërkimit shkencor; për hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësish të tjera; merr vendime për problemet financiare të fakultetit, në përputhje me autoritetin që i është deleguar atij; shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimin shkencor. Këshilli i fakultetit i propozon senatit akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Autoritetet drejtuese që veprojnë në SHLUJ UMB janë:

- Rektori
- Administratori i Deleguar/Drejtori i Përgjithshëm
- Dekani
- Drejtori i Institutit
- Përgjegjësi i Departamentit/Qendrës së Kërkimit dhe Zhvillimit

### 2.4. Programe të ofruara nga SHLUJ UMB

SHLUJ UMB ofron këto programme.
*Në ciklin e parë të studimeve* ofrohen këto programme:
Bachelor në - *Drejtësi*
Bachelor në - *Financë Kontabilitet*
Bachelor në - *Financë, Banka, Sigurime*
Bachelor në - *Kontabilitet, Auditim, Taksa*
Bachelor në - *Shkenca Politike*
Bachelor në – *Psikologji*
Bachelor në – *Sociologji*
Bachelor në - *Edukim Fizik dhe Sporte*
Bachelor në - *Gjuhë Angleze*
Bachelor në - *Gjuhë Gjermane*
Bachelor në - *Gjuhë Frënge*

Bachelor në - Menaxhim Biznesi
Bachelor në - Matematikë-administrim
Bachelor në - Matematikë-financë
Bachelor në - Administrim Biznesi
Bachelor në - Menaxhim
Bachelor në - Biznes
Bachelor në - Informatikë e Aplikuar
Bachelor në - Inxhinieri Sistemesh dhe Programesh Kompjuterike me profile:-*Inxhinieri softuerike-Menaxhim i databazave-Multimedia dizajn dhe zhvillim -Komunikim dixhital -Inxhinieri rrjeti*

*Në ciklin e dytë të studimeve* ofrohen këto programe:

MP në Shkenca Juridike: Profili: - *E Drejtë Publike- E Drejtë Biznesi*
MP në Administrim Biznesi: Profili:-*Financë Kontabilitet-Shërbime Bankare dhe Financiare-Prona të Pajuajtëshme dhe Sigurime*
MP në Shkenca Politike: Profili:-*Administrim Publik--Lidership*
MP në Komunikim: Profili: --*Gazetari Ekonomike-Komunikim Publik*
MP në Edukim: Profili: - *Mësimdhënie dhe të Nxënët-Administrim i Arsimit*
MP në Psikologji Ligjore
MP në Sociologji Zhvillimi: Profili: - *Zhvillim Social Komunitar – Zhvillim Ekonomik dhe Studim Tregu*
MP në Administrim Biznesi: Profili: - Lidership dhe Men. i Burimeve Njerëzore -Marketing dhe Menaxhim Operacionesh
MP në Menaxhim Transporti dhe Logjistikë
MP në Projektues në Arkitekturë të qëndrueshme
MP në Arkitekturë Interieri
MP në Arkitekturë Industriale
MP në Peisazh i Territorit Urbanistik Logjistik

Msc në Shkenca Juridike: Profili: - *E Drejtë Publike- E Drejtë Penale dhe Kriminologji - E Drejtë Tregtare- E Drejtë e Pronësisë Intelektuale*
Msc në Kontabilitet- Financë: Profili:-*Menaxhim Financiar-Shërbime Bankare dhe Financiare -Taksimi dhe Ligji-Kontabilitet*
Msc në Administrim Publik: Profili: -*Administrativ Ligjor-Administrativ Ekonomik*
Msc në Studime Evropiane: Profili: - *Marrëdhënie Ndërk. e Diplomaci -Politikat Evropiane dhe Administrim Publik -Studime Ekonomike Evropiane -E Drejtë Europiane*
Msc në Komunikim: Profili: - *Studime në Gazetari -Komunikim/Studime në Gazetari Ndërkombëtare-Komunikim/Marrëdhënie me Publikun Nivel Ndërkombëtar.*
Msc në Sociologji Zhvillimi Komunitar
**Msc** në Menaxhim Biznesi: Profili: -*Logjistikë dhe Menaxhim Operacional-Marketing Strategjik -Menaxhim i Burimeve Njerëzore-Menaxhim i Sistemeve të Informacionit*

Msc - Program Studimi i Integruar i Ciklit të Dytë në "Arkitekturë

Si rezultat i një bashkëpunimi ndërmjet SHLUJ UMB dhe Universitetit Clemson, është mundësuar ofrimi i Programit të UC "*PhD në Studime Ndërkombëtare për familjen dhe komunitetin*". Në këtë bashkëpunim SHLUJ UMB ofron shërbimet logjistike dhe administrative.

## III. REZULTATE TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Vlerësimi është bazuar në standardet për akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të parë. Për secilin standard dhe kriter kemi shprehur mendimet, argumentimet si dhe në fund të çdo standardi përmbledhje të tyre.

### PROGRAMI I STUDIMIT, MISIONI, ADMINISTRIMI

### 1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Në rregulloren e programit përcaktohet se: SHPULJP UMB ofron Programin Bachelor në "Administrim Biznesi", si program i ciklit të parë të studimeve, i cili mundëson një edukim sipas koncepteve moderne të administrimit të biznesit dhe përvetesimin e njohurive teorike dhe empirike mbi mënyrat dhe metodat e administrimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit. Programi synon pajisjen e studentëve me njohuri bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e aftësive të veçanta në administrimin efikas te organizatave te ndryshme te biznesit. Gjithashtu programi u ofron mundësinë studenteve që të fokusohen në qasjen funksionale të organizatës, por kanë mundësinë të thellohen dh enë në një numër të caktuar fushash akademike specifike siç janë: financa, kontabiliteti, etika, marketingu, shpërndarja, shitjet, biznesi elektronik, biznesi nderkombëtar, sipërmarrja apo menaxhimi i sistemeve të informacionit.

Programi Bachelor në "Administrim Biznesi" ka këto objektiva të përgjithshme:

a) të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqendruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën profesionale;
b) t'ju mundësojë studenteve përvetësimin e njohurive teorike dhe empirike mbi mënyrat dhe metodat e administrimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit.;
c) të integrojë mësimdhënien, kërkimin dhe shërbimet në mënyrë të tillë që të pasurojnë përvojën e të nxënit;
d) nëpërmjet kërkimit të zhvillohet dija dhe të përmirësohet praktika.

Programi ka një strukturë te tillë: një grup lëndësh te cilat njihen si Core curricula- curricula bazë, e cila ka në përbërje lëndë të tilla si Gjuhë angleze, IT, Sociologji, Mendimi ekonomik, Elementë të së Drejtës Publike, Metodat e Kërkimit dhe Shkrimi akademik, pra lëndë të formimit të përgjithshëm. E theksojmë këtë pasi pavarësisht numrit të stafit të angazhuar në Fakultetitn e Shkencave të Aplikuara për përmbushjen e tij janë të angazhuar dhe një numër i konsiderueshëm staf nga SHLUJ UMB, pasi nga pikëpamja financiare, përdorimit të mjediseve funksionon si një subjekt i vetëm.

VLERËSIMI SIPAS STANDARDEVE

| **STANDARDE/KRITERET** | **MENDIMI I GVB SA I TAKON PËRMBUSHJES SË STANDARDIT/KRITERIT** |
|---|---|
| **I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE** | |
| **Standardi I. 1**<br>**Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
| ***Kriteri 1***: Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); | Referuar dokumentacionit –programi i studimit “Bachelor” në Administrim Biznesi konstatohet se:<br>- Programi i studimit është hartuar konform Ligjit nr. 9741 “Për Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008 të MASH-së “Për organizimin e studimeve në IPAL”<br>- Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.<br><br>- Programi përmban 22 lëndë të modularizuara, duke përfshirë diplomën (teze/provim fomimi) (6 kredite).<br>- Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar në Udhëzimin Nr.15, datë 04.04.2008 të MASH ‘Për organizimin e studimeve në IPAL” si dhe në Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 të MASH-së “Për procedurat dhe okumentacionin për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës”, të kategorizuara si më poshtë:<br>A. Veprimtari formuese (36 kredite)<br>B. Disiplina karakterizuese (83 kredite)<br>C. Lëndëtëngjashme me disiplinat karakterizuaese (16 kredite)<br>D. Lëndë me zgjedhje (24 kredite)<br>E. Njohuri të tjera formuese (16 kredite)<br>F. Teza /Provimi i diplomës (5 kredite) |

| | |
|---|---|
| ***Kriteri 2:*** Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Bazuar në planin mësimor të programit të studimit, vërehet se një vit akademik ofron 60 kredite. |
| ***Kriteri 3:*** Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit; | Krahasimi i përmbajtjes së statutit të institucionit dhe rregullores së programit të studimit "Bachelor" për Administrim Biznesi, tregoi përputhje të programit përkatës me misionin e SHLUJ UMB dhe të programit. |
| ***Kriteri 4:*** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit; | Nga shqyrtimi i programit, dokumentit *Përligjja e programit* vërehet një përshkrim i qartë i objektivave formues të programit të studimit, duke cilësuar tipin e kompetencave (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme) që pritet të fitojnë studentët e Administrim Biznesit në përfundim të tij. |
| ***Kriteri 5***: Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës | Nisur nga qëllimi, objektivat formues dhe tërësia e komponentëve të tjerë të programit të studimit, rezulton se është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës për specialistë që priten të shërbejnë në sektorë të tillë si: biznese të vogla dhe të mesme, të industrive dhe dëgeve të ndryshme, po kështu në institucione në varësi të administratës publike, organizata jofitimprurëse etj. |
| ***Kriteri 6:*** Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. | Sipas të dhënave të marra nda anëtarët e fakultetit të Shkencave të aplikuara konstatohet se për hartimin e tij janë angazhuar autorite të spikatuara të fushës një pjesë e të cilëve janë përfshirë si mësimdhënës me kohë të pjesshme në stafin akademik të SHLUJ UMB. Këta individë kanë ofruar dhe njohuritë e tyre në lidhje me kërkesat e tregut të punës dhe përputhjen e programit me zhvillimin ekonomik të vendit. |

**Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI I.1 dhe KRITERET 1-6:**

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e prezantuara më lartë mund të themi se Programi Studimor "Bachelor" në Administrim Biznesi, ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e UMB-së si dhe me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

Ai realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.

| | |
|---|---|
| GVB konstatoi një përshkrim të qartë të objektivave formues të programit të studimit, duke cilësuar tipin e kompetencave (të përgjithshme, specifike dhe të transferueshme) që pritet të fitojnë studentët në përfundim të tij. | |
| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.** | |
| *Kriteri 1*: Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit | Programi i studimit realizohet në përputhje me strategjitë e zhvillimit të SHLUJ UMB. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë që ka në përgjegjësi programin e studimit, koordinon progresiin e tij me Planin e Zhvillimit Strategjik të institucionit. |
| ***Kriteri 2:*** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme; | Referuar strukturës së planit mësimor, vërehet se programi synon të pajisë studentët me njohuritë bazë të formimit shkencor dhe profesional, përmes kategorisë A dhe B të lëndëve të cilat krahasuar me kategoritë e tjera përbëjnë 119 kredite, nga 180 kredite që ka në total programi. |
| ***Kriteri 3:*** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh | Referuar strukturës së planit mësimor, vërehet se programi synon formimin e shprehive të veçanta nëpërmjet të lëndëve, të konsideruara si lëndë Minori, ku një pjesë e mirë e studentëve kanë zgjedhur minor në marketing, dhe një pjesë tjetër në minor e Drejtë Biznesi. Të dy këta minorë janë kompozuar për t'i mundësuar studentit shprehi në fusha më të veçanta por njëkohësisht dhe në përputhje me kushtet e tregut te punës, ku një pjesë e mirë e vendeve të punës ofrohen per pozicione si menaxherë shitjes, apo në kushtet kur bizneset janë të vogla dhe menaxherët duhet të kenë njohuri edhe në fushën e legjislacionit tregtar. |
| **Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI I.2 dhe KRITERET 1-3:**<br>Referuar treguesve të cilësisë të analizuar më lart, mund të konkludohet se programi i studimit i marrë në vlerësim rezulton në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit në tërësi. GVB e konsideron praktikë të mirë që programi i studimit BA në Administrim Biznesi synon pajisjen e studentëve jo vetëm me njohuritë bazë shkencore dhe profesionale por edhe me shprehi të transferueshme dhe ndihmëse duke kontrubuar në zgjerimin e mundësive për punësim në disa sektorë. | |
| **II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE** | |
| **Standardi II.1**<br>**- Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.** | |
| ***Kriteri 1:*** Programet e studimeve synojnë të | Bazuar në takimet me stafin drejtues dhe |

| | |
|---|---|
| plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar | mësimdhënës të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara rezulton se nëpërmjet instituteve kërkimore dhe shoqërive të grupit DUDAJ bëhen herë pas here investigime të tregut të punës dhe mësohet se programi administrim biznesi ka tërhequr vëmendjen e studentëve për shkak të orientimit në tregun e punës në këto vite, veçanërisht në sektorin privat. Kjo ka rezultuar edhe nga të dhënat e gjeneruara gjatë takimeve dhe vizitave të kryera nga sektori i marketingut në shkollat e mesme, për të identifikuar arsyet e zgjedhjes apo degët e preferuara të studentëve. |
| ***Kriteri* 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:<br>**a.** mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar;<br>**b**. kërkesat e punëdhënësve;<br>**c.** një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;<br>**d**. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. | - SHLUJ UMB konstatohet se ka një nivel të konsiderueshëm të njohjes të bazuar në studim për nevojat e tregut vendas dhe kërkesat për punësim.<br>- Përmes Zyrës së Këshillimit & Karrierës, SHLUJ UMB i ndihmon studentët e saj që të aftësohen për të aplikuar për punë, për të marrë kontakte me qendra pune, për të ndjekur panairin e punësimit, etj. Po kështu mbështet veprimtari në funksion të këtij qëllimi si pjesmarrje në panaire, organizime takimesh me kompani si Deloitte për aplikime p;r punë, organizime trajnimesh për përgatitjen e CV, pjesmarrje në projekte që lehtësojne intership-et e studentëve, etj,.<br>- Një pjesë e konsiderueshme e studentëve që ndjekin programin BA në Administrim Biznesi janë të punësuar me kohë të pjesshme, falë kësaj politike që ndjek SHLUJ UMB.<br>- SHLUJ UMB shprehet se parashikon 25 deri 30 studentë në vit të regjistruar në këtë degë.<br>- SHLUJ UMB shprehet se ka njohje të përafërt për numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet e tjera private, të cilat i konsideron si institucione serioze dhe që ofrojnë cilësi sikundër ajo, por shprehet e painteresuar për Institucionet e tjera për të cilat mendon se nuk aplikojnë standarde cilësore. |
| **Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI II.1 dhe KRITERET 1-2:**<br>Referuar treguesve të përshkruar më sipër, rezulton se programi i studimit BA në Administrim Biznesi | |

| | |
|---|---|
| synon të plotësojnë nevojat e tregut të punës. GVB e vlerëson si praktikë të mirë përpjekjen e SHLUJ UMB për të kryer studime në tregun e punës dhe që përmes Zyrës së Këshillimit për Karrierë mbështet studentët e saj që të aplikojnë për punë. | |
| **Standardi II.2**<br>**- Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.** | |
| *Kriteri 1*: Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare; | Programi i studimit BA në Administrim Biznesi ofrohet në pajtim me interesat kombëtare. |
| *Kriteri 2:* Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare | Edhe pse ruajtja e vlerave kombëtare nuk mund të identifikohet drejtpërdrejt mund të themi se jodrejtpërdrejt, duke ju referuar analizës së syllabuseve, literaturës por edhe lëndëve të veçanta të programit, programi i studimit synon të ndihmojë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare. Studentët janë përfshirë së bashku me studentë të programeve të tjerë të SHLUJ UMB që kontribuojnë në ruajtjen e vlerave kombëtare. |
| **Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI II.2 dhe KRITERET 1-2:**<br>Programi studimeve synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |

**2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

Programi i studimit bachelor në Administrim Biznesi ofrohet Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, i drejtuar nga Prof. As. Arben Bakllamaja dhe është një nga fakultetet më të rëndësishme të SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" dhe përbëhet nga Departamenti i Ekonomisë dhe Financës, Departamenti Biznes, Menaxhim, Turizëm, Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike si dhe Instituti i Kërkim Zhvillimit Barleti si dhe mbështetet nga Qendra e Trajnimit dhe Testimit Barleti.

Për hartimin dhe koordinimin e aktiviteteve didaktike dhe shkencore funksionon gjithashtu edhe Këshilli i Fakultetit i kryesuar nga Dekani, i përbërë prej 7 anëtarëve të zgjedhur nga personeli akademik me kohtë të plotë dhe të pjesshme të Fakultetit.

Pjesë e Fakultetit është edhe Qendra e Trajnimit dhe Testimit Barleti e cila ofron Kurset Soft Skills që kanë si qëllim të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së punës në organet e sektorit publik dhe privat.

Objektivat akademike dhe shkencore të mirëpërcaktuara dhe të ndara sipas strukturave përgjegjëse të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara, janë në përputhje të plotë me kërkesat më të reja për modernizmin e mësimdhënies në arsimin e lartë, duke ruajtur specifikat në fushën e drejtësisë.

Ndryshe nga programet e studimit në menaxhim, të cilët i përgatisin studentët për të planifikuar, organizuar dhe menaxhuar organizata ose departamente të veçanta të tyre, programi i studimeve në administrim biznesi ju ofron mundësinë studenteve që të fokusohen në përqasjen funksionale të organizatës. Kjo perqasje i mundëson studentit të thellohet në një numër të caktuar fushash akademike specifike siç janë: e drejta e biznesit, financa, kontabiliteti, etika, marketingu, shpërndarja, shitjet, biznesi elektronik, biznesi nderkombëtar, sipërmarrja apo menaxhimi i sistemeve të informacionit.

Krahas formimit në lëndët teorike bazë dhe në ato specifike studenti merr edhe njohuri plotësuese në drejtime të veçanta sipas kërkesave të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, përmes lëndëve të minorit.

**STRUKTURA**

- Këshilli i Fakultetit
- Departamenti i Ekonomisë dhe Financës
- Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizmit
- Departamenti i Arkitekturës dhe shkencave Kompjuterike

**Këshilli i Fakultetit**

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjial vendimmarrës i Fakultetit. Ai merr në shqyrtim dhe vendos për problemet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit.

Këshilli i Fakultetit përbëhet deri në 7 anëtarë, të cilët zgjidhen nga personeli akademik i Fakultetit. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Fakultetit është tre vjet. Zëvendësimi brenda mandatit i një anëtari të tij bëhet me kërkesë të Departamentit përkatës.

Anëtarët e Këshillit të Fakultetit përfaqësojnë personelin akademik të Fakultetit. Ata mund të jenë gjithashtu personel akademik i ftuar ose bashkëpunëtorë shkencorë të jashtëm. Si rregull, në Këshillin e Fakultetit janë të përfaqësuar të gjitha departamentet dhe njësitë kërkimore-shkencore të Fakultetit. Anëtari zgjidhet me votim të anëtarëve të personelit të njësisë që ai përfaqëson.

Dekani është anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit për shkak të detyrës dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Senatin.

Dekani thërret Këshillin e Fakultetit në mbledhje të rregullta një herë në 2-3 muaj. Rendi i ditës zakonisht propozohet nga Dekani. Këshilli i Fakultetit mund të mblidhet edhe në seancë të jashtëzakonshme me thirrjen e Dekanit, ose kur këtë e kërkon 1/3 e anëtarëve të tij.

**Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike** ky departament ka në fokus gërshetimin e teorisë dhe praktikës nëpërmjet projekteve dhe praktikave të punës për t’i mundësuar studentit një karrierë të nisur nga kërkesat e tregut, dhe jo e kundërta. Ai siguron arsimimin e lartë dhe kërkimin shkencor në fushën e arkitekturës, urbanistikës, shkencave kompjuterike dhe teknologjisë së informacionit. Departamenti nëpërmjet programeve të ofruara synon të pajisë studentët me njohuri akademike të

kompetencave kryesore të formimit profesional dhe të ballafaqimit me kompleksitetin dhe transformimet e vazhdueshme të qytetit, territorit dhe peisazhit bashkëkohore. Realizimi i një pjese të madhe të punës grafike, analitike bëhet nëpërmjet aplikimit të teknologjisë së informacionit. Kombinimi i trajnimeve të arsimit bazë me praktikat në terren, studiot arkitekturore, IT dhe kompanive të projektimit, do të rrisë aftësitë profesionale dhe mundësitë e punësimit. Po kështu formimi, që ky departament ofron në fushën e informatikës së aplikuar, mban parasysh ndryshimet të cilat vijnë si rezultat i transformimit dhe zhvillimit të teknologjisë së informacionit. Kombinimi i formimit bazë me minorë të zgjedhur nga studenti, si dhe me praktika mësimore pranë kompanive TI, e bën procesin mësimor shumë më interesant dhe rrit aftësitë profesionale, si dhe mundësitë e punësimit të studentëve.

**Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm:** Zhvillimi dinamik i biznesit dhe stukturimi i tij në një kontekst gjithnjë e më konkurrues kërkon edukimin e një elite të re të punonjësve dhe menaxhereve të ardhshëm, njohuritë dhe aftësitë e të cilëve, do të garantojnë konkurrueshmëri me efikasitet dhe sukses në tregjet vendase apo ndërkombëtare. Pikërisht formimi në fushën e biznesit, menaxhimit dhe turizmit mban parasysh ndryshimet që vijnë si rezultat i transformimit dhe zhvillimit të ekonomisë. Modulet, lëndët dhe temat që trajtohen, në programet eofruara gjatë gjithë kohëzgjatjes së formimit, janë të përshtatura plotësisht me realitet ekonomike, me pritshmëritë e studentëve, si dhe me nevojat konkrete të organizatave të biznesit. Kombinimi i formimit bazë me profilet e zgjedhura nga studenti, si dhe me praktika mësimore pranë sipërmarrjes e bën procesin mësimor shumë më interesant dhe rrit aftësitë profesionale, si dhe mundësitë e punësimit të studentëve.

**Departamenti i Ekonomisë dhe Financës:** Departamenti i Ekonomisë dhe Financës prezantohet me një program të plotë studimesh universitare që synon të përgatisë specialistë për një karrierë të ardhshme si ekspertë kontabël, financierë, apo analistë financash të institucioneve të ndryshme private apo publike, të tillë që në të ardhmen të mund të thellojnë studimet apo të specializohen për financat e shtetit, për bursën, për tregjet e sigurimeve etj.

**Qendra e Trajnimit dhe Testimit Barleti BTTC -** Kjo qendër mundëson trajnime intensive në rajone të vendit, me tematika të ndryshme për të krijuar ekipet e specialistëve që realizojnë përcaktimin e prioriteteve, shkrimin e projekteve dhe realizimin e tyre në terrenin konkret, etj. Më konkretisht kjo qendër ofron:

**CERTIPORT -** Certiport është lider botëror i bazuar në provimet e certifikuara për institucione aka demike, në korporata dhe në IT. *Certiport* është i autorizuar në 12,000 qendra testimi në gjithë botën. Qëllimi kryesor i *Certiport* është t'i ofrojë individëve kredenciale dhe aftësi dixhitale aktuale dhe relevante për fuqinë punëtore konkurrente në mbarë globin. ***Certiport*** mundëson provimet e certifikimit përmes një rrjeti të specializuar të qendrave të testimit. Qendrat janë të pozicionuara në mënyrë unike për të siguruar nivelin më të lartë të testimit, besueshmërinë dhe performancën e duhur. Shërbimet që ofron:

- Microsoft Office Specialist (MOS)
- The Adobe Certified Associate (ACA)
- Microsoft Technology Associate IT

**PEARSON - Testimi i gjuhës angleze**

PTE General është qendra më e madhe e testimit të Gjuhës Angleze, me rreth 500 degë në të gjithë botën. Kjo qendër ka një diapazon të gjerë, që përfshin të gjitha nivelet e testimit të kësaj gjuhe, A1, A2, B1, B2, C1, C2. Testi PTE General është bashkëkohor dhe njihet në të gjithë botën. BTTC gjithashtu ofron kurse intensive përgatitore dy muaj përpara testit, tre herë në javë, nga dy orë. Testi është i kompozuar nga dy pjesë: Testimi me gojë (një javë përpara atij me shkrim, me një kohëzgjatje 5-8 min.) dhe Testimi me shkrim, (datën ndërkombëtare të testit).

PROMETRIC TESTING CENTER - Prometric ofron rrjetin më të gjerë, profesional dhe të sigurt për testim në botë, testet e të cilit realizohen në mbi 160 shtete me mbi 7500 vendndodhje në total. APTC (Authorized Prometric Testing Center) Qendrat realizojnë provime për certifikim nga kompanitë lider në fushën e teknologjisë së informacionit si Microsoft, CompTia, Apple, HP, etj.

NEW HORIZONS - Me 300 qendra të shpërndara në 60 shtete të ndryshme, New Horizons është kompania më e madhe, e pavarur e edukimit IT në botë. Nga aplikimi bazë dhe mjetet produktive të desktopit, të cilat kompletojnë dhe integrojnë sistemet e biznesit, New Horizons paraqet një hapësirë të plotë të teknologjisë. Pas 25 vjetësh, New Horizons ofron zgjidhje të reja, të cilat kanë transformuar biznesin dhe kanë zgjeruar ofertat, vendodhjet, si dhe kanë përmbushur një numër të konsiderueshem kërkesash të organizatave. Në të njëjtën kohë New Horizons ka ndihmuar dhe stimuluar 25.000.000 studentë në rritjen e qëllimeve përsa i përket karrierës dhe punësimit të tyre. BTTC është qendër e autorizuar e New Horizons.

Struktura përgjegjëse për programin e studimit siç e përmendëm më lart është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, departamenti i Biznes - Menaxhim - Turizmit. Përbërja e stafit jepet në tabelën në vijim. Për realizimin e kurrikulës është angazhuar edhe stafi akademik i SHLUJ "*Universiteti Marin Barleti*".

***Tabela: 2.1. Stafi i fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë***

| **FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMISË** | |
|---|---|
| ***Prof. Ass. Arben Bakllamaja, Dekan i Fakultetit*** | |
| Departamenti i Biznes,Menaxhimit, Turizmit | |
| *Gazmend Zeneli, PhD.* | *përgjegjës i dept.* |
| *Reis Mulita, PhD.* | |
| *Valentina Ndou, Dr.* | |
| *Jorgest Kovaçi, Msc ,Doktorant* | |
| *Vjollca Backa, Msc* | |
| *Flora Krasniqi, Msc* | |
| *Valbona Elmazi, Msc* | |
| *Gjithsej: 7* | |
| *Profesor: 0* | |
| *Doktorë shkencash 3* | |
| *Doktorantë 1* | |
| *Master 2* | |

| Departamenti i Ekonomisë dhe Financës | |
|---|---|
| *Jorgji Bollano,Prof.Dr* | *përgjegjës i dept.* |
| *Arben Bakllamaja, Prof.As.* | |
| *Nevruz Koçi, Prof.Dr.* | |
| *Semiha Loca, Dr.* | |
| *Brikena Tolli, Msc* | |
| *Jonida Taraj, MSc,Doktorant* | |
| *Asije Koprencka, Msc* | |
| *Miranda Berdo, Msc* | |
| *Gjithsej: 8* | |
| *Profesor: 2* | |
| *Profesor i Asociuar: 1* | |
| *Doktorë shkencash: 1* | |
| *Doktorantë: 1* | |
| *Master 3* | |
| Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike | |
| *Arbana Kadriu, Prof.Ass.* | *përgjegjës i dept.* |
| *Marenglen Spiro, Prof.Dr.* | |
| *Andi Gjokutaj, Msc* | |
| *Amir Esmaeilakhtar, Bsc* | |
| *Dorealda Dalipaj, Msc* | |
| *Spartak Bakllamaja, Msc* | |
| *Anjeza Llubani, Msc* | |
| *Ajda Çarçani, Msc* | |
| *Oltion Luga, Msc* | |
| *Gjithsej: 9* | |
| *Profesor. Dr.:1* | |
| *Profesor Ass: 1* | |
| *Master 6 dhe Bachelor 1* | |

Sa i takon Këshillit të fakultetit ai ka përbërjen si vijon:

*Tabela 2.2."Këshilli fakultetit"*

| Emër Mbiemër | Titulli/grada | Pozicioni në Këshillin shkencor |
|---|---|---|
| Arben Bakllamaja | Prof.As. | Kryetar |
| Arbana Kadriu | Prof.Ass | Anëtar |
| Gazmend Zeneli | PhD | Anëtar |
| Semiha Loca | Dr. | Anëtar |
| Bardhyl Ceku | Prof.Dr. | Anëtar |
| Igli Tafa | Dr. | Anëtar |
| Ardiana Gjonaj | Prof.Dr. | Anëtar |

## 3. Personeli akademik dhe ai mbështetës

| Nr. | Moduli | Lënda | Pedagogu i lendes | Titulli | I brendshem/ jashtem | Tipi i Veprimtarisë | Gjithsej (kredite) | Gjithsej (orë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjuhë Angleze | Gjuhë Angleze | Gëzim Hadaj | Prof.Dr. | B | E | 6 | 60 |
| 2 | Teknologji Informacioni | Teknologji Informacioni | Andi Gjokutaj | MSc. | B | E | 6 | 60 |
| 3 | Mendimi Ekonomik | Mendimi Ekonomik | Asije Koprencka | M.Sc | B | A | 6 | 60 |
| 4 | Elementët e së Drejtës Publike | Elementët e së Drejtës Publike | Ledian droboniku | PhD | B | A | 6 | 60 |
| 5 | Sociologji | Sociologji | Saemira Pino | Dr. | B | A | 6 | 60 |
| 6 | Matematikë | Matematikë | Marenglen Spiro | Prof.Dr. | B | A | 6 | 60 |
| 7 | Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik | Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik | Gazmend Zeneli | Dr. | B | A | 6 | 60 |
| 8 | Mikro dhe Makroekonomia | Parimet e Mikroekonomisë | Jorgest Kovaçi | Dnt. | B | B | 6 | 60 |
| 9 | Statistikë | Statistikë | Nevruz Koçi | Prof.Dr. | B | A | 6 | 75 |
| 10 | Menaxhim Financiar | Menaxhim Financiar | Brikena Tolli | MA | B | C | 6 | 60 |
| 8 | Mikro dhe Makroekonomia | Parimet e Makroekonomisë | Miranda Berdo | MA | B | B | 6 | 60 |
| 11 | Marketing dhe Komunikim | Bazat e Marketingut | Bardhyl Ceku | Prof.Dr. | J | B | 6 | 60 |
| 12 | Kontabilitet për Administrim Biznesi | Bazat e Kontabilitetit | Jorgji Bollano | Prof.Dr. | B | B | 6 | 60 |
| 13 | Administrim Biznesi | Bazat e Menaxhimit | Jorgest Kovaçi | Dnt. | B | B | 6 | 60 |
| | | Sipërmarrja dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogël | Asije Koprencka | MSc. | B | B | 6 | 60 |
| 14 | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | Asije Koprencka | MSc. | B | B | 6 | 60 |
| 15 | Menaxhim Projektesh | Menaxhim Projektesh | Arben Bakllamaja/Flora Krasniqi | Prof.ass./ MA | B | B | 6 | 60 |
| 16 | Biznesi Elektronik dhe Ndërkombëtar | Biznesi Elektronik dhe Ndërkombëtar | Jonida Taraj | M.Sc | B | B | 6 | 60 |
| 17 | Emërtimi i Minorit/Profilit të Zgjedhur | Minori marketing/ Kërkim Marketing | Bardhyl Ceku | Prof.Dr. | J | D | 6 | 60 |
| | | Minori marketing/ Marketing Ndërkombëtar | Semiha Loca | Prof. As. Dr. | B | D | 6 | 60 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Minori e drejtë biznesi/ e drejtë civile | Valbona Alikaj | Drnt. | B | D | 6 | 60 |
| | | Minori e drejtë biznesi/ e drejtë e detyrimeve | Valbona Alikaj | Drnt. | B | D | 6 | 60 |
| 18 | Financim Investimesh dhe Menaxhim Portofoli | Financim Investimesh dhe Menaxhim Portofoli | Lirola Këri | MSc. | J | C | 6 | 60 |
| 11 | Marketing dhe Komunikim | Drejtim Marketingu dhe Komunikim | Bardhyl Ceku | Prof.Dr. | J | B | 5 | 60 |
| 19 | Promocioni dhe Shitja | Promocioni dhe Shitja | Semiha Loca | Prof. As. Dr. | B | B | 6 | 60 |
| 20 | Etika dhe Vendimmarrja në Biznes | Etika e Biznesit | Jorgest Kovaç | Dnt. | B | B | 6 | 60 |
| | | Vendimmarrja | Jonida Taraj | MSc. | B | B | 6 | 60 |
| 21 | Ekonomia Urbane dhe Imobiliare | Ekonomia Urbane dhe Imobiliare | Gazmend Zeneli | Dr. | B | C | 4 | 45 |
| 12 | Kontabilitet për Administrim Biznesi | Kontabilitet Drejtimi | Brikena Tolli | MA | B | B | 6 | 60 |
| 17 | Emërtimi i Minorit/Profilit të Zgjedhur | Minori marketing/Sjellje Konsumatore | Semiha Loca | Prof. As. Dr. | B | D | 6 | 60 |
| | | Minori marketing/Shpërndarja | Semiha Loca | Prof. As. Dr. | B | D | 6 | 60 |
| | | Minori e drejtë biznesi/ e drejtë tregtare | Edlira Lloha | MSH | B | D | 6 | 60 |
| | | Minori e drejtë biznesi/ e drejtë financiare | Edlira Lloha | MSH | B | D | 6 | 60 |
| 22 | Praktikë dhe Punim Diplome | Praktikë pranë Sipërmarrjes | Departamenti | | | E | 4 | 90 |

**Ndërsa stafi i angazhuar me kontratë për programin aktual është:**

***Tabela: 2.3. Stafi me kontratë i fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë gjatë tre viteve të fundit për programin bachelor Administrim Biznesi***

| Fakulteti i ***Shkencave të Aplikuara*** dhe Ekonomisë - Stafi i angazhuar me kontratë gjatë viteve | | |
|---|---|---|
| Bardhyl Ceku | Prof. Dr | UBT- Baza marketing, Drejtim dhe Kërkim marketing |
| Lirola Këri | Doktorante | Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit- Financim Investimesh dhe Menaxhim Portofoli |

Sa i takon stafit administrativ, fakulteti ka një koordinator programi që është Jonida Taraj. Ndërsa stafi administrativ është stafi që i shërben të gjithë SHLUJ Universiteti Marin Barleti, pra stafi administrativ funksionon në nivel shkolle, jo në nivel fakulteti.

*Tabela 2.4 Të dhënat e stafit sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre*

| Titulli | PA Efektiv (PAE) | PAKontratë (PAK) | Raporti PAE/PAK |
|---|---|---|---|
| Profesorë | 4 | 1 | 4:1 |
| Profesorë të Asoc. | 2 | 0 | 2:0 |
| Doktorë | 3 | 0 | 34:0 |
| Pedagogë –Doktorant | 3 | 0 | 3:0 |
| Asistentë me Ma | 6 | 1 | 6:1 |
| Asistentë pa Ma | - | | - |
| Personeli Administrativ | Funksionon në nivel shkolle | | |

*Tabela 2.5. Të dhëna PAE sipas moshës*

| Personeli sipas titujve /gradave | Numri i PAE dhe PA me moshë: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (25-35) | (36-45) | (46-55) | (56-65) | (66-....) |
| Profesorë | | | | 1 | 3 |
| As. Prof | | | 1 | 1 | |
| Doktorë | 1 | 1 | | 1 | |
| Pedagogë Doktorante | 3 | | | | |
| Asistentë me Ma | 4 | 1 | 1 | | |
| Asistentë pa Ma | | | | | |
| Personeli Administrativ | Funksionon në nivel shkolle | | | | |

*Tabela 2.6. Të dhëna PAK sipas moshës*

| Personeli sipas titujve /gradave | Numri i PAK me moshë: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | (25-35) | (36-45) | (46-55) | (56-65) | (66-68) |
| Profesorë | | | | 1 | |
| As. Prof | | | | | |
| Doktorë | | | | | |
| Pedagogë Doktorant | 1 | | | | |
| Asistentë me Ma | | | | | |
| Asistentë pa Ma | | | | | |

**Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Çdo anëtar i stafit akademik dhe administrativ nënshkruan në fillim të çdo viti akademik kontratën e punës me Administratorin e Deleguar/Drejtorin e Përgjithshëm, ku përcaktohen të gjitha detyrimet dhe të drejtat e palëve. (referojuni kontratave). SHLUJ UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Pjesë e vlerësimit të stafit referuar kontratave të personelit janë disa aspekte: mësimdhënia, kërkimi shkencor, dhe kontributi në projekte. SHLUJ UMB ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës, që ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhëave etj. Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut për nivelet e larta të drejtimit (neni 28-30 i Statutit) ndërsa për stafin tjetër sipas nenit 23 të Statutit të SHLUJ UMB, është Bordi që miraton kriteret kryesore arsimore për stafin që rekrutohet. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit të lirë nga strukturat përkatëse (eprori i drejtpërdrejtë).

| **STANDARDE/KRITERET** | **MENDIMI I GVB SA I TAKON PËRMBUSHJES SË STANDARDIT/KRITERIT** |
|---|---|
| **III - PERSONELI I INSTITUCIONIT** | |
| Standardi III.1<br>- Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit. | |
| *Kriteri 1* Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; | Rekrutimi i punonjësve të rinj bëhet mbi bazën e kritereve dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren e brendshme të institucionit. Përparësi i jepet pesonelit të kualifikuar në vend dhe në universitetet e njohura ndërkombëtare. Insitucioni publikon vendet bosh dhe kriteret përkatëse në web site. Përdor sistem pikëzimi vlerësimi. Anëtarë të stafit akademik janë dhe shtetas të huaj qoftë të punësuar qoftë brenda marrëveshjeve për programet Fullbright (p.sh pedagogë që kanë asistuar në lëndën e gjuhës angleze) |
| *Kriteri 2* Personeli akademik i punësuar me kohë të | Në Programin BA në Administrim Biznesi |

| | |
|---|---|
| plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve<br>të ciklit të parë; | aktualisht janë gjithsej 20 pedagogë në total të angazhuar për zhvillimin e programit të studimit të marrë në vlerësim, 18 prej tyre janë me kohë të plotë dhe 2 janë me kohë të pjesshme. Po kështu 93 % e ngarkesës mësimore të planifikuar për këtë program studimi, mbulohet nga pedagogë me kohë të plotë. |
| *Kriteri 3* Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; | SHLUJ UMB ndjek procedura ligjore (bazuar në kontratën e punës, kjo e fundit në Kodin e punës) dhe transparente të vlerësimit të personelit. Një mënyrë është aplikimi i pyetësorit të vlerësimit nga studenti të programit dhe mësimdhënësve. Pjesë e vlerësimit të stafit referuar kontratave të personelit janë disa aspekte: mësimdhënia, kërkimi shkencor, dhe kontributi në projekte. Vlerësimi për këto aspekte bëhet respektivisht nga Eprori i Drejtpërdrejtë, Administratori, Drejtuesi i projektit. SHLUJ UMB ka të miratuar manualin e rekrutimit ku pasqyrohen në mënyrë të detajuar dhe kriteret, mënyra e vlerësimit të stafit. (referuar formularit të vlerësimit të stafit) |
| Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj. | SHLUP UMB ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI III.1 dhe KRITERET 1-4<br>SHLUJ UMB ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të personelit. Rrekrutimi i punonjësve të rinj në institucion bëhet mbi bazën e kritereve dhe procedurave ligjore të parashikuara edhe në Rregulloren e Brendshme të institucionit, Manualin e Rekrutitmit të Stafit akademik të cilat u bëhen të njohura dhe aplikantëve. | |
| Standardi III.2<br>- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij | |
| *Kriteri 1* Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit; | Zyra e Burimeve Njerëzore në SHLUJ UMB është njësia e ngarkuar me përgjegjësinë direkte për ruajtjen e të dhënave të personelit drejtues, akademik dhe administrativ. Zyra e BNJ ruan dhe administron një informacion të hollësishëm për personelin. Të dhënat janë depozituar në formë të printuar dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. |

| | |
|---|---|
| *Kriteri 2* Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ; | Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës dhe administarativ. |
| *Kriteri 3* Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; | Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik janë të përfshira në Statut për nivelet e larta të drejtimit (neni 28-30 i Statutit) ndërsa për stafin tjetër sipas nenit 23 të Statutit të SHLUJ UMB, është Bordi që miraton kriteret kryesore arsimore për stafin që rekrutohet. Ndërkohë kriteret propozohen në varësi të vendit të lirë nga strukturat përkatëse (eprori i drejtpërdrejt). |
| Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore "Doktor„ ose titullin akademik "Docent„. | Institucioni ka angazhuar në pjesën më të madhe të programit si titullarë të lëndëve/moduleve personel me grada dhe tituj shkencor. Referuar listës emërore të personelit të angazhuar për realizimin e programit studimor, vërehet se nga 20 pedagoge të angazhuar 5 janë Profesorë, 2 Prof.As, 3 Dr., 3 doktorantë dhe 7 me master, një pjesë e mirë studjuar jashtë ose me eksperiencë pune profesionale veçanërisht ata që mbulojnë lëndët e fushës. Angazhimi i pedagogëve të brendshëm është rritur karahasuar me vitet e tjera akademike, që pasqyrohet në shkallën e mbulimit të ptogramit nga stafi me kohë të plotë. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI III.2 dhe KRITERET 1-4<br>SHLUJ UMB disponon një bazë të dhënash për personelin e tij që ruhet dhe administrohet me përgjegjësi nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Të dhënat janë depozituar në formë të printuar dhe një pjesë në formë elektronike. Në këtë njësi mund të gjesh listën e plotë të personelit, dokumentacionin lidhur me kriteret e rekrutimit të personelit dhe të dhëna për kualifikimin e stafit. Referuar listës emërore të personelit të angazhuar për realizimin e programit studimor, vërehet se nga 20 pedagoge të angazhuar 5 janë Profesorë, 2 Prof.As., 3 Dr., dhe të tjerët me master apo doktorantë, një pjesë e mirë studjuar jashtë ose me eksperiencë pune profesionale veçanërisht ata që mbulojnë lëndët profesionale të fushës. | |
| Standardi III.3<br>- Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor, shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij. | |
| *Kriteri 1* Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; | SHLUJ UMB ka angazhuar personel ndihmës mësimor–shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për instruktimin e orëve praktike. Për mirëmbajtjen e laboratorëve ka staf ndihmës të |

| | |
|---|---|
| | punësuar apostafat për këtë qëllim. |
| *Kriteri 2* Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë; | SHLUJ UMB ka një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të parë; |
| *Kriteri 3* Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë). | SHLUJ UMB ka vënë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Mbikqyrja dhe vlerësimi bëhet nga një anëtar i stafit akademik dhe asistohet nga Koordinatori i departamentit. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI III.3 dhe KRITERET 1-3<br>SHLUJ UMB ka të punësuar personel ndihmës mësimor, shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij. Mbikqyrja dhe drejtimi i praktikave profesionale bëhet nga një anëtar i stafit akademik dhe asistohet nga koordinatori i departamentit. Në praktikën e SHLUJ UMB për mirëmbajtjen e laboratoreve dhe mjediseve shkollore, konstatohet aplikimi i politikës së punësimit të stafit me kohë të plotë. | |
| Standardi III.4<br>- Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. | |
| *Kriteri 1* Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; | SHLUJ UMB është aktivisht e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të tij që kryesisht lidhet me shpërndarjen e informacioneve shkencore, mbështetjen për pjesmarrje në konferenca e seminare kombëtare dhe rajonale, si dhe përfshirjen në studime konkrete. Gjithashtu për stafin e ri akademik janë organizuar dhe seminare me pedagogë të huaj (janë shfrytëzuar burimet e stafit të huaj të punësuar në universitet dhe ata të programit fullbright). Është bërë traditë organizimi i lektoriumeve nga profesorë të Universitetit apo të huaj, të cilët shërbejnë dhe si model për stafin e ri. |
| Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara. | SHLUJ UMB disponon dokumentacione që dëshmojnë për angazhimin e tij në veprimtari që synojnë kualifikimin e personelit. GVB ju vunë në dispozicion programe trajtimi të stafit të brendshëm të kryera nga Michael Totterdell dhe Christina Standerfer. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI III.4 dhe KRITERET 1-2<br>SHLUP UMB është aktivisht e angazhuar për kualifikimin e mëtejshëm profesional të punonjësve të tij. Në funksion të kësaj ka organizuar veprimtari kualifikuese me staf të huaj me ekperiencë, me staf të | |

brendshm po kështu me kualifikime jashtë, me staf të universiteteve të huaja në kuadër të angazhimeve të tyre në SHPLU “Universiteti Marin Barleti”.

## 4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Për realizimin e programeve të studimit SHLUP UMB ka dy kampuse. Në kampusin 1 janë të përqendruar kryesisht studimet bachelor. Në total ka një sipërfaqe të konsiderueshme përdorimi të destinuar për salla leksionesh, laboratore, zyra, hapësira parkimi, mjedise shplodhëse, hapësira të gjelbra, hapësira të lira qarkullimi që pasqyrohen në tabelat në vijim dhe planimetritë në ankesin”Planimetritë”. Asetet, si toka dhe ndërtesa janë në pronësi të Grupit DUDAJ (Kampusi 1) dhe SHLUJ UMB (kampusi 2), pra të gjitha në pronësi të aksionerëve të shoqërisë themeluese të SHLUJ UMB. Në mbështetje të studentëve funksionojë shërbimi i fotokopjeve, mensa, bibloteka, Zyra e Rekrutimit, Zyra e Këshillimit, Mentorët e Grupeve, Dekani i studentëve etj.

**<u>Tregues të matshëm:</u>**

Tabela 4.1: Mjediset e SHLUJ Universiteti Marin Barleti

| Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit | | Sipërfaqja |
|---|---|---|
| Salla për leksione | 25 | 1020 |
| Klasa për seminare | | |
| Salla për aktivitete promovuese | 2 | 174 |
| Salla për praktikë lëndore/ profesionale | | |
| Laboratorë për lëndët | | |
| Laboratorë informatike | 4 | 143 |
| Salla interneti (ëireless në të gjithë sipëfaqen, godinat) | 2 | 88 |
| Salla për bibliotekë | 2 | 70 |
| Mjedis për fotokopjime, librari etj | 2 | 8 |
| Zyrë informacioni për studentët | 4 | 48 |
| Korridore/holle | 2 | 200 |
| Mjedise sportive (fushë e jashtme) | 1 | 40 |
| Mjedise shërbimi për të tretë | | |
| Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore | 1 | 6 |
| Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj | | 843 |
| Nyje hidrosanitare për studentët | 9 | 50 |
| Etj.... | | |
| **Norma $m^2$/për student** | 9.35 m2/student | |

| Mjediset për stafin: | Sasia | Sipërfaqja |
|---|---|---|
| Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin | 5 | 64 |
| Zyra për sekretarinë mësimore | 2 | 12 |
| Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore | 3 | 40 |
| Zyra për personelin akademik | | 758 |
| Zyrë për financën | 2 | 12 |
| Zyrë për Njësinë e SBC | 2 | 12 |
| Salla për mbledhje | 2 | 30 |
| Mjedis për stafin e shërbimit | 3 | 30.25 |
| Nyje hidrosanitare për personelin akademik | 8 | 42 |
| | | |
| **Norma $m^2$/për person** | 15m2/person | |

☑ Dokumentacioni përkatës (planimetritë)në Aneksin "Planimetritë"

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI** | |
|---|---|
| Standardi V. 1<br>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij. | |
| *Kriteri 1* Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore. | SHLUJ UMB vë në dispozicion të studentëve të këtij programi, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij, si dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyera. Në funksion të kësaj funksion dhe UMB press e cila ka mundësuar publikimin, mbështetjen e pedagogëve të ndryshëm për botimin e teksteve të tyre si tekste të Nevruz Koçi, Jorgji Bollano, Luan Omarit, etj. |
| *Kriteri 2* Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit; | Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij. |
| *Kriteri 3* Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit; | Sipas drejtuesve të programit, biblioteka ka rreth 120 tituj, rreth 700 njësi librash.<br>Drejtuesit e Fakultetit sugjerojnë pasurimin e fondit të biblotekës me libra çdo vit në varësi të kërkesave nga departamentet dhe në gjykimin e tyre në bibliotekë ka literaturë të fushës në sasi të mjaftueshme që ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit. Një pjesë tjetër e fondit të biblotekës është në formatin e-book. (mbi 250 tituj) nga shtepite botuese me te mira si Blackwell publishing, Haworth Press, Oxford University press, CRC press, Elsevier, etc. |

| | |
|---|---|
| | Krahas këtyre shfrytëzohen bibloteka apo website online. Per ti ardhur ne ndihme te studenteve per gjetjen e literatures shkencore ne database, eshte instaluar programi END NOTE X. |
| *Kriteri 4* Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të. | Përgjegjësit e departamenteve hartojë listat për titujt me të cilët duhet pasuruar bibloteka, e cila i dorëzohet administratës. |
| *Kriteri 5* Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve. | Biblioteka ka të shpallur orarin e sa i përshtatur me kërkesat e studentëve. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI V.1 dhe KRITERET 1-5<br>SHLUJ UMB ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij, me kushte komode për lexim dhe me 120 tituj, 700 njësi librash. Në gjykimin e GVB është një praktikë e mirë dhe tashmë e përmirësuar krahasuar me vitet e mëparsh, me përfshirja e fondit elektronik të librave. Por rekomandohet që kjo të ruhet në vazhdimësi, me qëllim që të ndihmohen studentët që të realizojnë komponentin e kërkimit shkencor të inkuadruar në qëllimet e programit të studimit. | |
| Standardi V. 2<br>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik | |
| *Kriteri 1* Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve; | Institucioni ka në shfrytëzim dy kampuse me disa godina rreth 1020 $m^2$ sipërfaqe auditorë, 878 $m^2$ sipërfaqe zyra për stafin, 143$m^2$ sipërfaqe laboratorë, 139$m^2$ sipërfaqe për veprimtari ndihmëse, si dhe mjedise të tjera shlodhjeje dhe mensa. SHLUJ UMB disponon rreth 200 kompjutera, 50 % e të cilëve të destinuar për studentët, rreth 20 laptop. Sallat janë të pajisura me projektor, ose përdoren ato portabël.<br>Në proces implementimi ngritja e disa laboratorëvepër qëllime më specifike si Laboratori i Informatikës dhe Arkitekturës, Laboratori për Qendrën e Kurseve në CISCO, Ndërtimi i laboratorit OCIL (Open Creative Innovation Lab).<br>Nga këto të dhëna (shih gentplanet e godinave dhe sipërfaqeve të tjera) konstatohet se SHLUJ UMB ka sasi të mjaftueshme për laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit. |
| *Kriteri 2* Pajisjet e mjediseve mësimore janë të | Pajisjet në mjediset për zhvillimin e programit |

| | |
|---|---|
| përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit; | studimor në vlerësim, rezultojnë të përshtatshme për mësimdhënie. |
| *Kriteri 3* Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve; | SHLUJ UMB ka laboratorë të IT, Gjuhës së Huaj, Testimeve Pearson. Laboratorët përmbajnë mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit. |
| *Kriteri 4* Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator. | Laboratorët janë të lidhur me lëndë të veçanta të programit si IT, gjuha e huaj. |
| *Kriteri 5* Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhinieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj,. | Institucioni disponon tre salla interneti të pajisur me kompjutera dhe aksesorë të multimedias. Njëri prej laboratorëve ka të instaluar dhe Sisteme operative që janë janë WindowsXP dhe Linux. Software të instaluar janë : MySql, Java, BlueJ, Microsoft Visual Studio, SPSS, XAMPP. |
| *Kriteri 6* Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale. | Institucioni garanton bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe subjekte të tjera private, që janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave si dhe në bizneset e Grupit DUDAJ. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI V.2 dhe KRITERET 1-6<br>SHLUJ UMB ka vënë në dispozicion të studentëve mjedise të përshtatshme mësimore. Ka tre laboratorë të IT dhe testimit të gjuhës së huaj, pasi SHLUJ UMB është licensuar nga qendra e testimeve Pearson. | |

**5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

SHLUJ Universiteti Marin Barleti është shoqëri tregtare. Si e tillë ajo arkëton të ardhura kundrejt shërbimeve të ofruara. Ndaj të ardhurat e saj janë ato të siguruara nga tarifat e studimit, që paguajnë studentët. Në institucion funksionojnë disa zyra/individë të ngarkuar për përmbushjen e detyrave financiare: Kancelari i Universitetit, Shefi i Financës, financierët. Në vitin e fundit fiskal (2014) kostoja për student ka rezultuar 1213 Euro. Shoqëria i nënshtrohet auditimit çdo vit nga ekspert financiar, si dhe sipas interesit të aksionerëve kryhen dhe kontrolle e auditime t;ë tjera me ekspertë të shoqërive të grupit Dudaj. Gjithashtu i është nënshtruar dhe kontrollit nga organet tatimore. Të dhënat në vijim janë marrë nga bilancet e shoqërisë, të cilat pasqyrojnë të dhëna fiskale sipas viteve kalendarikë.

**Tregues të matshëm:**

☑ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit jepen në tabelën në vijim:

Tabela 5.1.Të ardhurat për tre vitete e fundit

| **Të ardhurat nga:** | Viti 2012 | Viti 2013 | Viti 2014 |
|---|---|---|---|
| Pushteti qendror | | | |
| Pushteti vendor | | | |
| Fonde jopublike: | | | |
| Grantet për kërkim dhe kontratat | | | |
| Konsulencat, shërbimet | | | |
| Tarifat për dhe gjatë shkollimit | 107, 562, 540 | 99,385,000 | 88,812,000 |
| Sponsorizimet | | | |
| Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) | | 7,953,294 | 8,792,332 |
| Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj | | | |
| Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) | | | |
| Të tjera (qera, ndryshime kursi valutor, interesa bankare) | 170,220 | 193,789 | 424,222 |
| **SHUMA** | **107,562,760** | **107,532,083** | **98,028,554** |

| **Shpenzimet për vitin akademik 2014** | Viti 2014 |
|---|---|
| Paga e sigurime | 64,485,208 |
| Shpenzime operacionale | 11,188,584, |
| Shpenzime kërkimi e zhvillimi | 2,246,550 |
| Shpenzime studentore | 557,530 |
| Shpenzime marketingu | 8,452,028 |
| Shpenzime infrastrukture e amortizime | 5,269,622 |
| **SHUMA** | **92,199,522** |

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| **VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR** | |
|---|---|
| Standardi VI.1<br>- Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. | |
| *Kriteri 1* Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve - të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; | SHLUJ UMB harton pasqyra e raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin e institucionit. |
| *Kriteri 2* Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike; | Institucioni dokumenton raportet fiannciare. Kjo dhe sipas diskutimit të bërë me kancelarin e universitetit ndodhen prane zyrës së financës dhe te depozituar dhe prane Drejtorisë Rajonale te tatim |

| | |
|---|---|
| | taksave, qendrën Kombëtare të regjistrimit te bizneseve. |
| Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Po, përgjatë viteve SHLUJ UMB është karakterizuar nga qendrueshmëri financiare e cila ka gjeneruar dhe një normë fitimi. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI VI.1 dhe KRITERET 1-3<br>SHLUJ UMB harton pasqyra e raporte financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat përfshihen dhe në plan buxhete e institucionit; është karakterizuar nga qendrueshmëri financiare e cila ka gjeneruar dhe një normë fitimi. | |
| Standardi II.5<br>- Institucioni vlerëson dhe dokumeton gjendjen e tij financiare. | |
| *Kriteri 1* Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij; | Referuar informacionit të dhënë nga Kancelari rezulton se SHLUJ UMB kryen auditime të brendshme të herëpashershme për çështje të ndyshme, ose gjatë fazës së hartimit të projektbuxhetit. Gjithashtu aplikohen dhe auditime të jashtme, si dhe disa herë universiteti i është nënshktruar kontrollit përkatës të Degës së Tatim Taksave. |
| *Kriteri 2* Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj.; | Referuar po informacionit të dhënë nga Kancelari i Universitetit rezulton se ka raporte auditimi të cilat i paraqiten aksionerëve. |
| *Kriteri 3* Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë. | *Po.* Ka disa projekte në të cilat është përfshirë Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, të fituara si individualisht dhe me partnerë të huaj. Nder keto mund te permenden: (1)“Art, Plastic and Recycling” mbeshtetur nga Delegacion i BE-se ne Tirane me nje vlere rreth 90 000 EUR; (2)“National Biodiversity Strategy and Action Plan” mbeshtetur nga Banka Boterore dhe Fondi Boteror per Mjedisin (GEF) me nje vlere rreth 61 000 USD, nderkohe qe eshte ne pritje te financimit te projektit “Greening the Apps- IT application”. Në te gjithe këto projekte ka dhe përfshirje të studentëve. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI II.5 dhe KRITERET 1-3<br>Bazuar në informacionin e ofruar nga Kancelari i Universitetit rezulton se SHLUJ UMB i është nënshtruar si auditimit të brendshëm edhe atij të jashtëm. Gjithashtu grandet e fituara nëpërmjet aplikimeve me projekte të ndryshme përfshihen në raportimet përkatëse dhe të dhënat financiare të qendrave/instituteve të kërkimit. | |

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programit të studimit

SHLUJ UMB ka përgjegjësinë përpara shoqërisë shqiptare që të ofrojë një cilësi të lartë të mësimit, të kërkimit dhe të shërbimeve; të demonstrojë se po bën përpjekjet e mundshme më të mira për të përdorur me efektshmëri burimet dhe të garantojë se standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur. Sigurimi i cilësisë shtrohet me theks të veçantë edhe për një sërë arsyesh të tjera, si: zhvillimi i SHLUJ UMB, kërkesat e reja të shoqërisë shqiptare, konkurrenca, europianizimi, internacionalizimi i arsimit të lartë dhe objektivat e Procesit të Bolonjës.

Për të garantuar cilësinë, efektshmërinë e kërkuar dhe përmbushjen e standardeve, SHLUJ UMB ka miratuar dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ka ngritur organizmat e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Dokumenti i politikës së vlerësimit përmban kriteret e sigurimit të cilësisë, funksionet e organizmave të sigurimit të cilësisë dhe procedurat e vlerësimit të brendshëm.

Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe akreditimit. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë. Akreditimi kryhet nga organizma të përcaktuara sipas ligjit.

Vlerësimi i brendshëm është procesi që kryhet nga institucioni, programi i studimit për të gjykuar për përmbushjen e standardeve të cilësisë, është një reflektim kolektiv institucional dhe një mundësi për të përmirësuar cilësinë. Procesi i vlerësimit të brendshëm përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogëve dhe të studentëve. Ky proces përmbyllet me një raport që analizon statusin e institucionit ose/dhe të programit të studimit përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në SHLUJ UMB vepron **Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e përbërë nga dy seksione:**

- Seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve bachelor
- Seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve master

NJSBC ka autonomi vepruese dhe akses për të gjitha të dhënat në SHLUJ UMB. Roli i NJSBC është të krijojë një kulturë që synon të arrijë dhe ruajë një cilësi të lartë të veprimtarisë akademike dhe kërkimore në SHLUJ UMB.

**Funksione të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë:**

*Në fushën e sigurimit të cilësisë*

- Të zbatojë politikën e vlerësimit të cilësisë në SHLUJ UMB;
- Të hartojë planin kalendar të realizimit të veprimtarive të vlerësimit të brendshëm në nivel institucioni;
- Të monitorojë cilësinë brenda SHLUJ UMB;
- Të organizojë procesin e vlerësimit të brendshëm;
- T'u ofrojë njësive bazë të SHLUJ UMB shërbime këshillimi për vlerësimin e brendshëm dhe përmirësimin e cilësisë;
- Të udhëzojë njësitë bazë të SHLUJ UMB për përgatitjen e raporteve të vlerësimit për programet që mbulojnë dhe veprimtarinë e njësive përkatëse;

- T'i asistojë grupit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm;
- Të ruajë të dhënat e vlerësimit të brendshëm;
- Të publikojë raportet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të organizojë programe trajnimi për sigurimin e cilësisë brenda SHLUJ UMB;
- Të përgatisë Manualin e Sigurimit të Cilësisë;
- Të bashkëpunojë me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë për veprimtarinë e sigurimit të cilësisë.
- Të marrë pjesë në programet e trajnimit dhe në takimet që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë në Shqipëri.

*Në fushën e akreditimit*

- Të përgatisë dhe të ndjekë procesin e akreditimit institucional dhe të programeve;
- Të ruajë të dhënat e procesit të akreditimit;
- Të bashkëpunojë me APAAL për procesin e akreditimit;
- Të publikojë vendimet e akreditimit.

*Në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit*

- Të nxisë veprimtaritë për përmirësimin e cilësisë në SHLUJ UMB;
- Të lehtësojë zbatimin e rekomandimeve të raporteve të vlerësimit për institucionin, programet dhe të monitorojë ecurinë e zbatimit të tyre;
- Të jetë një pikë qëndrore për planifikimin institucional, përfshirë edhe përmirësimin e programeve aktuale dhe zhvillimin e programeve të reja;
- Të rivlerësojë programet e monitorimit dhe të vlerësimit të brendshëm;
- Të kryejë analiza mbi bazën e të dhënave të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtë;
- Të publikojë buletine të vlerësimit;
- Të bashkëpunojë me NJSBC të institucioneve të tjera të arsimit të lartë për të shkëmbyer përvojën dhe për të rritur cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri.

Njësia e sigurimit të Cilësisë përgatit çdo vit vlerësime të cilësisë të cilat janë diskutuar dhe në mbëdhje të veçanta në senat. Njësia e sigurimit të Cilësisë është ngritur që në vitin 2009. Në vitin 2010 u bë organizimi i saj me dy seksione.

Komisioni (Grupi) i Vlerësimit të Brendshëm: është një organizëm që ngrihet dhe funksionon në nivel institucioni i cili ka përgjegjësinë për të garantuar se SHLUJ UMB i plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet për politikën së vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. KSC i raporton drejtpërdrejt Senatit të SHLUJ UMB.

SHLUP UMB është një institucion i Akredituar, gjithashtu i është nënshtruar proceseve të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit të disa programeve në nivel bachelor dhe master.

Tabela 6.1. Të dhëna për anëtarët e NJBSC

| | Anëtarët e NJBSC | Detyra që ka në në NJBSC | Sa kohë ka në këtë detyrë |
|---|---|---|---|
| 1 | Semiha Loca, Dr. | Specialist, Studimet bachelor | 2009 |
| 2 | Migena Kapllanaj, Doktorante | Specialiste, Studimet master | 2010 |
| 3 | Robert Gjedia,Dr. | Specialiste, Studimet master | 2014 |

Njësia e Sigurimit të cilësisë kryen anketime çdo semestër, dy javë përpara mbarimit të tij. Pra, me secilin grup, çdo vit, dy herë. Përgjithësisht tendenca ka qenë për të marrë mendime për çdo lëndë të programit. Numri i studentëve të anketuar ndryshon nga njëri anketim në tjetrin, në varësi dhe të studentëve të pranishëm në momentin e kryerjes.

Të gjithë pyetsorët përpunohen dhe mendimet e shprehura i paraqiten me shkrim rektorit. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në Senat.

Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikul, përmirësime të niveleve të shërbimit, përfundime kontratash me staf akademik, etj. Forma të tjera të vlerësimit të programit janë mendimet e gjeneruara nga pedagogët, veçanërisht stafi i jashtëm, nga zyrat e rekrutimit, këshillimit.

Raportet e vlerësimit gjenden pranë zyrës së cilësisë dhe pranë rektorit për raportet përmbledhëse të diskutuara në senat.

**<u>Vlerësimi sipas Standardeve</u>**

| Standardi II.3<br>- Institucioni, për akreditimin e prograneve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre. | |
|---|---|
| *Kriteri 1*: Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; | SHLUJ UMB ka institucionalizuar praktikën e sigurimit të cilësisë së brendshme duke ngritur NJSBC. Kjo njësi, ndjek me përgjegjësi procesin e vlerësimit të cilësisë, duke matur ecurinë e programeve të studimit për qëllime përmirësimi. Në këtë proces, NJSBC përdor një metodologji të caktuar, me instrumente matese dhe vlerësuese të tilla si: pyetesor, (kjo referuar raporteve të vlerësimit të pjesshëm , pyetsorëve të plotësuar nga studentët të ofruara nga Zyra e Sigurimit të Cilësisë), raporte të posaçme për pedagogët, etj., ku përfshihen studentët dhe stafi. Në procesin e vlerësimit të stafit përfshirja e Departamentit të Burimeve njerëzore është e konsiderueshme, pasi vlerësimi përfshin jo vetëm aspektin akademik (i cili bëhet jo vetëm nëpërmjet instrumentave që përdor NJSBC por edhe nga eprori i drejtpërdrejtë), por edhe aspekti i punës kërkimore, administrative |

| | |
|---|---|
| | që bëhet nga individë të ndryshëm si Drejtori i Institutit. (bazuar në kontratat e stafit akademik) |
| *Kriteri 2*: Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional | SHLUJ UMB e përfshin këtë informacion në RVB. Nga dokumentacioni kemi diskutime të vlerësimit të brendshëm edhe në nivel mbledhje të veçanta senati. (shih vendime të senatit) |
| *Kriteri 3:* Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; | SHLUJ UMB informon studentët për rezultatet e VB, procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomës. |
| *Kriteri 4:* Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:<br>Të tërthorta:<br>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve;<br>b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;<br>c. Pyetje konceptuale;<br>d. Intervista;<br>e. Etj.<br>Të drejtpërdrejta:<br>a. Teste të standardizuara kombëtare/ ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);<br>b. Dëgjime në auditor;<br>c. Vlerësimi me nota/pikë;<br>d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;<br>e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);<br>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës;<br>g. Etj | SHLUJ UMB përdor praktika, procedura dhe instrumente të shumta vlerësimi, monitorimi e evidentimi të cilësisë, si: pyetësorët, intervistat, rezultatet e detyrave, testimeve paraprake, provimeve, vëzhgime në praktikë, feedback nga pedagogët.<br><br>GVB shqyrtoi disa prej instrumenteve të përdorura nga institucioni, si: pyetesor për studentët, vlerësues për praktikën- raportin e pedagogut, etj. të cilët lejojnë të merret informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të deklarohet se SHLUJ UMB përdor praktika, procedura dhe instrumente të shumta vlerësimi, monitorimi e evidentimi të cilësisë, si: pyetësorët, rezultatet e detyrave, testimeve paraprake, provimeve, pjesore, feedback nga pedagogët. (nga anëtarët e departamentit ju ofruan GVB punime të studentëve, kopje të testeve të përdorur). Nga Agjencia Shqiptare e Akreditimit është ofruar Manuali i vlerësimit të Brendshëm i cili aplikohet si një dokument mjaft i rëndësishëm vlerësimi. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI II.3 dhe KRITERET 1-4<br>Për akreditimin e progranеve të studimeve, SHLUJ UMB përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre. GVB siguroi disa formate pyetësorësh për studentët dhe raporte për pedagogët të cilat shërbejnë si instrumente për të siguruar informacion për mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit në vlerësim. Por, GVB vëren se këto instrumente mund të pasurohen dhe përmirësohen më tej. Nga Agjencia Shqiptare e Akreditimit është ofruar Manuali i vlerësimit të Brendshëm i cili aplikohet si një dokument mjaft i rëndësishëm vlerësimi. | |
| | |
| **Standardi VIII.1**<br>**- Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve**. | |
| *Kriteri 1* Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; | SHLUP UMB ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në me Urdhrin Nr. 288 datë 04.09.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. SHLUP UMB ka fituar |

| | |
|---|---|
| | akreditimin institucional dhe akreditimin e programeve të studimit: BA në Menaxhim Biznesi, BA në Financë-Kontabilitet, BA në Shkenca Politike, DIND në Drejtësi. (4 vjeçar). Me urdhrin nr. 337 datë 16.08.2013 të Ministrit të Arsimit Shkolla e Lartë Universitare "Universiteti Marin Barleti" ka marrë akreditimin pozitiv për programet e studimit *Bachelor në Drejtësi, Bachelor në Psikologji, Bachelor në Sociologji.* |
| *Kriteri 2* Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; | SHLUJ UMB ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. SHLUJ UMB ka përgatitur një sërë instrumentesh të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë. |
| *Kriteri 3* Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron; | SHLUJ UMB ka përgatitur dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre. |
| *Kriteri 4* Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron; | SHLUJ UMB kryen shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpas-hershme të programeve të studimit. |
| *Kriteri 5* Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; | SHLUJ UMB ka përgatitur materiale dhe ka organizuar trajnime për informimin dhe ndërgjegjësimin e stafit dhe të studentëve për sigurimin e cilësisë dhe rolin e tyre në këtë proces. |
| *Kriteri 6* Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar. | SHLUJ UMB ka hartuar dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë bërë publike. Aktualisht nga Agjencia e Akreditimit janë ofruar udhëzuesi dhe manuali i sigurimit të cilësisë. |

| |
|---|
| **Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI VIII.1 dhe KRITERET 1-6** |
| SHLUJ UMB ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në me Urdhërin Nr.288 datë 04.09.2009 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. SHLUJ UMB ka fituar akreditimin institucional dhe akreditimin e programeve të studimit: BA në Menaxhim Biznesi, BA në Financë-Kontabilitet, BA në Shkenca Politike, DIND në Drejtësi. (4 vjeçar). Me urdhrin nr. 337 datë 16.08.2013 të Ministrit të Arsimit Shkolla e Lartë Universitare "Universiteti Marin Barleti" ka marrë akreditimin pozitiv për programet e studimit *Bachelor në Drejtësi, Bachelor në Psikologji, Bachelor në Sociologji.* SHLUJ UMB ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. SHLUJ UMB ka përgatitur dokumentin e politikës së vlerësimit dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre. |

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

**Pjesa përshkrimore**

Në rregulloren e programit përcaktohet se: SHPULJP UMB ofron Programin Bachelor në "Administrim Biznesi", si program i ciklit të parë të studimeve, i cili mundëson një edukim sipas koncepteve moderne të administrimit të biznesit dhe përvetesimin e njohurive teorike dhe empirike mbi mënyrat dhe metodat e administrimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit. Programi synon pajisjen e studentëve me njohuri bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e aftësive të veçanta në administrimin efikas te organizatave te ndryshme te biznesit. Gjithashtu programi u ofron mundësinë studenteve që të fokusohen në qasjen funksionale të organizatës, por kanë mundësinë të thellohen dh enë në një numër të caktuar fushash akademike specifike siç janë: financa, kontabiliteti, etika, marketingu, shpërndarja, shitjet, biznesi elektronik, biznesi nderkombëtar, sipërmarrja apo menaxhimi i sistemeve të informacionit.

Programi Bachelor në "Administrim Biznesi" ka këto objektiva të përgjithshme:

a) të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqendruar në njohuritë dhe kompetencat kyçe të domosdoshme për t'i përdorur në karrierën profesionale;
b) t'ju mundësojë studenteve përvetësimin e njohurive teorike dhe empirike mbi mënyrat dhe metodat e administrimit të funksioneve apo veprimtarive të ndryshme të biznesit.;
c) të integrojë mësimdhënien, kërkimin dhe shërbimet në mënyrë të tillë që të pasurojnë përvojën e të nxënit;
d) nëpërmjet kërkimit të zhvillohet dija dhe të përmirësohet praktika.

Programi ka një strukturë te tillë: një grup lëndësh te cilat njihen si Core curricula- curricula bazë, e cila ka në përbërje lëndë të tilla si Gjuhë angleze, IT, Sociologji, Mendimi ekonomik, Elementë të së Drejtës Publike, Metodat e Kërkimit dhe Shkrimi akademik, pra lëndë të formimit të përgjithshëm. E theksojmë këtë pasi pavarësisht numrit të stafit të angazhuar në Fakultetitn e Shkencave të Aplikuara për përmbushjen e tij janë të angazhuar dhe një numër i konsiderueshëm staf nga SHLUJ UMB, pasi nga pikëpamja financiare, përdorimit të mjediseve funksionon si një subjekt i vetëm.

Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar në Udhëzimin Nr.15, datë 04.04.2008 të MASH 'Për organizimin e studimeve në IPAL" si dhe në Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 të MASH-së "Për procedurat dhe okumentacionin për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës", të kategorizuara si më poshtë:
A. Veprimtari formuese (36 kredite)
B. Disiplina karakterizuese (83 kredite)
C. Lëndëtëngjashme me disiplinat karakterizuaese (16 kredite)
D. Lëndë me zgjedhje (24 kredite)
E. Njohuri të tjera formuese (16 kredite)
F. Teza /Provimi i diplomës (5 kredite)

SHLUJ Universiteti Marin Barleti përdor një model syllabusi i cili përban të dhëna në lidhje me: qëllimin,

modulin ku përfshihet lënda, kategorizimin e lëndës sipas veprimtarisë, semetrin kur zhvillohet, pedagogu përgjegjës dhe të dhënat e komunikimit me të nga ana e studentëve, qëllimi dhe objektivat e lëndës, literatura bazë dhe plotësuese, format e testimit, temat që trajtohen, detyrimet që duhet të respektojë studenti, nëse ka ose parakushte për të ndjekur këtë lëndë. (referuar syllabuse te programit Bachelor në Administrim Biznesi).

Organizimi i moduleve, lëndëve, ndarjes sipas semestrave, orëve në auditor dhe jashtë auditorit, jepen në vijim, sipas viteve.

Tabela 7.1.: Plani mësimor bachelor në Administrim Biznesi

**Plani Mësimor (Viti I)**

| Nr. | Moduli | Lënda | Kodi i Lëndës | Tipi i Veprimtarisë | Ngarkesa Totale ne Orë | | | | | | | | Ngarkesa Javore në Orë | | | | | | | | | | | | | | Orë Individuale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | Semestri 1 | | | | | | | Semestri 2 | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | Javë | | | | | | | Javë | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | 15 | 15 | 15 | 15 | 15 | 15 | | 15 | 15 | 15 | 15 | 15 | 15 | | |
| | | | | | Gjithsej (kredite) | Gjithsej (orë) | Leksione | Seminare / Ushtrime | Laboratore | Projekte/Detyra Kursi | Praktikë | Tezë Diplome | Leksione | Seminare / Ushtrime | Laboratore | Projekte/Detyra Kursi | Praktikë | Tezë Diplome | Provime | Leksione | Seminare / Ushtrime | Laboratore | Projekte/Detyra Kursi | Praktikë | Tezë Diplome | Provime | |
| 1 | Gjuhë Angleze | Gjuhë Angleze | ANG 014 | E | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 1 | 1 | | | | | | 1 | 1 | | | | | | 90 |
| 2 | Teknologji Informacioni | Teknologji Informacioni | INF 015 | E | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 1 | 1 | | | | | | 1 | 1 | | | | | | 90 |
| 3 | Mendimi Ekonomik | Mendimi Ekonomik | MEK 016 | A | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 4 | Elementët e së Drejtës Publike | Elementët e së Drejtës Publike | DPB 013 | A | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 5 | Sociologji | Sociologji | SOC 011 | A | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 6 | Matematikë | Matematikë | MAT 701 | A | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 7 | Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik | Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik | MSH 012 | A | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 8 | Mikro dhe Makroekonomia | Parimet e Mikroekonomisë | PMI 241 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 9 | Statistikë | Statistikë | STA 243 | A | 6 | 75 | 45 | 30 | | | | | | | | | | | | 3 | 2 | | | | | x | 75 |
| 10 | Menaxhim Financiar | Menaxhim Financiar | MFN 202 | C | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| | **Gjithsej** | | | | **60** | **615** | **315** | **300** | | | | | **10** | **10** | | | | | | **11** | **10** | | | | | | **885** |
| | | | | | | | | | | | | | **20 orë javore** | | | | | | | **21 orë javore** | | | | | | | |

**Plani Mësimor (Viti II)**

| Nr. | Moduli | Lënda | Kodi i Lëndës | Tipi i Veprimtarisë | Ngarkesa Totale ne Orë: Gjithsej (kredite) | Gjithsej (orë) | Leksione | Seminare / Ushtrime | Laboratore | Projekte/Detyra Kursi | Praktikë | Tezë Diplome | Ngarkesa Javore në Orë – Semestri 1 (Javë): Leksione (15) | Seminare / Ushtrime (15) | Laboratore (15) | Projekte/Detyra Kursi (15) | Praktikë (15) | Tezë Diplome (15) | Provime | Semestri 2 (Javë): Leksione (15) | Seminare / Ushtrime (15) | Laboratore (15) | Projekte/Detyra Kursi (15) | Praktikë (15) | Tezë Diplome (15) | Provime | Orë Individuale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | Mikro dhe Makroekonomia | Parimet e Makroekonomisë | PMA 241 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 11 | Marketing dhe Komunikim | Bazat e Marketingut | BMK 121 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 12 | Kontabilitet për Administrim Biznesi | Bazat e Kontabilitetit | BKT 201 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 13 | Administrim Biznesi | Bazat e Menaxhimit | BMX 103 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| | | Sipërmarrja dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogël | SMB 103 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 14 | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | MXN 105 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 15 | Menaxhim Projektesh | Menaxhim Projektesh | MXP 103 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 16 | Biznesi Elektronik dhe Ndërkombëtar | Biznesi Elektronik dhe Ndërkombëtar | BEN 104 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 17 | Emërtimi i Minorit/Profilit të Zgjedhur | Lënda 1 | | D | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| | | Lënda 2 | | D | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| | **Gjithsej** | | | | **60** | **600** | **300** | **300** | | | | | **10** | **10** | | | | | | **10** | **10** | | | | | | **900** |
| | | | | | | | | | | | | | **20 orë javore** | | | | | | | **20 orë javore** | | | | | | | |

## Plani Mësimor (Viti III)

| Nr. | Moduli | Lënda | Kodi i Lëndës | Tipi i Veprimtarisë | Ngarkesa Totale ne Orë: Gjithsej (kredite) | Gjithsej (orë) | Leksione | Seminare / Ushtrime | Laboratore | Projekte/Detyra Kursi | Praktikë | Tezë Diplome | Ngarkesa Javore në Orë – Semestri 1 – Javë: Leksione (15) | Seminare / Ushtrime (15) | Laboratore (15) | Projekte/ Detyra Kursi (15) | Praktikë (15) | Tezë Diplome (15) | Provime | Semestri 2 – Javë: Leksione (15) | Seminare / Ushtrime (15) | Laboratore (15) | Projekte/ Detyra Kursi (15) | Praktikë (15) | Tezë Diplome (15) | Provime | Orë Individuale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | Financim Investimesh dhe Menaxhim Portofoli | Financim Investimesh dhe Menaxhim Portofoli | IMP 202 | C | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 11 | Marketing dhe Komunikim | Drejtim Marketingu dhe Komunikim | DMK 121 | B | 5 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 65 |
| 19 | Promocioni dhe Shitja | Promocioni dhe Shitja | PRS 122 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| 20 | Etika dhe Vendimmarrja në Biznes | Etika e Biznesit | EBZ 110 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| | | Vendimmarrja | VNM 110 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 21 | Ekonomia Urbane dhe Imobiliare | Ekonomia Urbane dhe Imobiliare | URB 109 | C | 4 | 45 | 30 | 15 | | | | | | | | | | | | 2 | 1 | | | | | x | 55 |
| 12 | Kontabilitet për Administrim Biznesi | Kontabilitet Drejtimi | KDR 209 | B | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 17 | Emërtimi i Minorit/Profilit të Zgjedhur | Lënda 3 | | D | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | 2 | 2 | | | | | x | | | | | | | | 90 |
| | | Lënda 4 | | D | 6 | 60 | 30 | 30 | | | | | | | | | | | | 2 | 2 | | | | | x | 90 |
| 22 | Praktikë dhe Punim Diplome | Praktikë pranë Sipërmarrjes | PRK 171 | E | 4 | 90 | | | | | 90 | | | | | | | | | | | | | 6 | | | 10 |
| | | Punim Diplome | DPL 196 | F | 5 | 10 | | | | | | 10 | | | | | | | | | | | | | 0.7 | | 115 |
| | Gjithsej | | | | 60 | 625 | 270 | 255 | | | 90 | 10 | 10 | 10 | | | | | | 8 | 7 | | | 6 | 0.7 | | 875 |
| | | | | | | | | | | | | | 20 orë javore | | | | | | | 21.7 orë javore | | | | | | | |

☑ Plani mësimor  i ndarë sipas Veprimtarive Formuese jepet në tabelën në vijim

Tabela 7.2. Plani mësimor sipas veprimtarive formuese

| **PLANI MËSIMOR për programin e studimit Bsc në Administrim Biznesi** | | | |
|---|---|---|---|
| Tipi i Veprimtarisë (A-F) | Lënda/Moduli | Kreditet | Totali |
| Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (**A**) | Mendimi Ekonomik | 6 | **36** |
| | Elementët e së Drejtës Publike | 6 | |
| | Sociologji | 6 | |
| | Matematikë | 6 | |
| | Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik | 6 | |
| | Statistikë | 6 | |
| Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (**B**) | Parimet e Makroekonomisë | 6 | **83** |
| | Bazat e Marketingut | 6 | |
| | Bazat e Kontabilitetit | 6 | |
| | Bazat e Menaxhimit | 6 | |
| | Sipërmarrja dhe Menaxhimi i Biznesit të Vogël | 6 | |
| | Menaxhim i Burimeve Njerëzore | 6 | |
| | Menaxhim Projektesh | 6 | |
| | Biznesi Elektronik dhe Ndërkombëtar | 6 | |
| | Drejtim Marketingu dhe Komunikim | 5 | |
| | Promocioni dhe Shitja | 6 | |
| | Etika e Biznesit | 6 | |
| | Vendimmarrja | 6 | |
| | Kontabilitet Drejtimi | 6 | |
| | Parimet e Mikroekonomisë | 6 | |
| Veprimtari në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (**C**) | Menaxhim Financiar | 6 | **16** |
| | Financim Investimesh dhe Menaxhim Portofoli | 6 | |
| | Ekonomia Urbane dhe Imobiliare | 4 | |
| Veprimtari në disiplina me zgjedhje (**D**) | Minori marketing/Kërkim Marketing | 6 | **24** |
| | Minori marketing/Marketing Ndërkombëtar | 6 | |
| | Minori marketing/Sjellje Konsumatore | 6 | |
| | Minori marketing/Shpërndarja | 6 | |
| Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (**E**) | Gjuhë Angleze | 6 | **16** |
| | Teknologji Informacioni | 6 | |
| | Praktikë pranë Sipërmarrjes | 4 | |
| Teza e Diplomës (**F**) | | 5 | **5** |

**Vlerësimi sipas standardeve**

| **Standardi I. 1**<br>**Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.** | |
|---|---|
| *Kriteri 1*: Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); | Referuar dokumentacionit –programi i studimit "Bachelor" në Drejtësi konstatohet se:<br>- Programi i studimit është hartuar konform Ligjit nr. 9741 "Për Arsimin e Lartë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008 të MASH-së "Për organizimin e studimeve në IPAL"<br><br>- Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 180 ECTS në total.<br><br>- Programi përmban 22 lëndë të modularizuara, duke përfshirë diplomën (teze/provim fomimi) (5 kredite).<br><br>- Ndarja e lëndëve/moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar në Udhëzimin Nr.15, datë 04.04.2008 të MASH 'Për organizimin e studimeve në IPAL" si dhe në Udhëzimin Nr.11, datë 28.02.2011 të MASH-së "Për procedurat dhe okumentacionin për hapjen e një Institucioni Privat të Arsimit të Lartë, Programeve të reja të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimit jo universitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës", të kategorizuara si më poshtë:<br>A. Veprimtari formuese (36 kredite)<br>B. Disiplina karakterizuese (83 kredite)<br>C. Lëndëtëngjashme me disiplinat karakterizuaese (16 kredite)<br>D. Lëndë me zgjedhje (24 kredite)<br>E. Njohuri të tjera formuese (16 kredite)<br>F. Teza /Provimi diplomës (5 kredite) |
| *Kriteri 2:* Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite; | Bazuar në planin mësimor të programit të studimit, vërehet se një vit akademik ofron 60 kredite. |
| **Standardi II.4**<br>**- Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese** | |
| *Kriteri 1* Njësitë kryesore, përgjegjëse për një | Njësia kryesore përgjegjëse e programit në vlerësim është Departamenti i Biznesit, Menaxhim, Turizmit pranë fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, të SHLUJ UMB. Kjo njësi disponon dhe |

| | |
|---|---|
| program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve | jep informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit. Zyra e pranimit, Zyra e këshillimit ju ofron informacion studentëve që gjatë procesit të interesimit. Po kështu Institucioni organizon javën e parë të çdo viti akademik, prezantimin e programit, rregulloreve, pedagogët dhe CV e tyre. (referuar programit të javës së parë të përgatitur Dekani i studentëve në bashkëpunim me deparatementet). |
| *Kriteri 2* Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër | Anëtarët e departamentit, Tutorët e grupeve dhe Zyra e Këshillim Karrierës jep informacionin përkatës. Veçanërisht Zyra e Këshillim Karrierës krahas këshillimit përgatit dhe pyetsorët për përzgjedhjen e minorit (paketë lëndësh me zgjedhje gjatë javës së parë të vitit të dytë akademik) |
| *Kriteri 3* Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit | Departamenti informon studentët për orët mësimore, frekuentimin, etj. Por edhe çdo pedagog orën e parë të mësimit prezanton syllabusin, detyrimet afatet e shlyerjes së detyrimeve. |
| *Kriteri 4* Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën<br>lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj | Stafi mësimdhënës jep informacion të detajuar për syllabuset e tyre, ose për praktikat dhe përmbajtjet e tjera mësimore. Në lidhje me praktikat departamenti ka një pedagog të brendshëm që merret drejtpërdrejt me praktikën e studentëve, që i orienton, ndjek, dhe informon studentët. Departamenti disponon dokumentacionin për informim. |
| **Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI II.4 dhe KRITERET 1-4**<br>Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga departamenti dhe bashkëbisedimin me drejtuesin e departametit përgjegjës për programin e studimit BA në Administrim Biznesi GVB konkludon se njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi jep informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë për programin përkatës. GVB konstatoi se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit, disponon dokumentacionin e nevojshëm për informim (program studimi, plan mësimor, syllabuse lëndore, etj.) në formë elektronike dhe të printuar. | |

## 8. Mësimdhënia

**Pjesa përshkrimore**

Mësimdhënia organizohet duke kombinuar disa forma, si leksione, seminare, prezantime të detyrave të studentëve, prezantim i videove të ndryshme në varësi të temave dhe diskutimi në lidhje me to, prezantim i rasteve të ndryshme nga praktika, diskutime mbi artikuj të ndryshëm nga revista të biznesit etj.. Po kështu organizimi i lektoriumeve me figura të njohura të fushës. Sa i takon vlerësimit përgjithësisht përqindjet variojnë sipas lëndëve dhe kritereve që përdoren. Format e mësimdhënies dhe ngarkesa përkatëse jepen në tabelën 8.1. dhe 8.2. në vijim. Gjithashtu studentët bëhen pjesë dhe e projekteve të Fakultetit apo qendrave kërkimore.

Tabela 8.1. Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies

| **Programi i Studimit Bachelor në Administrim Biznesi** |
|---|

| Format e mësimdhënies | Orët totale në auditor |
|---|---|
| Leksione | 885 |
| Seminare | 855 |
| Ushtrime | |
| Laboratore | |
| Praktikë lëndore | |
| Praktikë profesionale | 90 |
| Etj | 2660 |
| Në total | 4490 |

Tabela 8.2: Format e kontrollit të njohurive

| Format e kontrollit të njohurive | **Pjesa (në %) ndaj totalit** |
|---|---|
| Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive | 10% |
| Plotësimi i detyrimeve (detyra individuale, ne grup) | 20-30% |
| Testimet gjatë vitit | 20% |
| Provimi përfundimtar | 40-50% |
| Etj | |
| Në total | **100%** |

☑ Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë (Plotëso Tabelën 8.3)

Tabela 8.3. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë

| **Aktiviteti shkencor i IAL** | **Numri i studentëve të aktivizuar** |
|---|---|
| Për punime shkencore individuale të pedagogëve | - |
| Për projekte shkencore në rang Departamenti | 6 |
| Për projekte shkencore në rang Fakulteti | - |
| Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë | 1 |

## 9. Studentët

**<u>Pjesa përshkrimore</u>**

**Kriteret e pranimit për programet e diplomave të Nivelit I (universitar**)

Për pranimin në programin Bachelor në Administrim Biznesi, studentët duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton përfundimin e të paktën një shkolle të mesme si dhe të plotësojnë formularin e aplikimit. Pranohen për të ndjekur studimet universitare edhe kandidatët që vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një institucion i arsimit të lartë publik ose jo publik. Studentët që regjistrohen për herë të parë në SHLUJ UMB, i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes. Përzgjedhja bëhet nga një komision i ngritur nga Universiteti. Komisioni, si rregull, bën klasifikimin e kandidatëve mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga ata si dhe nëpërmjet intervistimit a testimit, kur kjo gjykohet e nevojshme. Nëse dokumentacioni i plotësuar rezulton në përputhje me kërkesat e përcaktuara, merret vendimi për pranimin dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurave te regjistrimit. Komisioni përzgjedhës shpall listën e kandidatëve që pranohen të ndjekin studimet në SHLUJ "Universiteti Marin Barleti", sipas programeve të studimit, profileve dhe minorëve duke caktuar edhe afatin përfundimtar të regjistrimit.

Gjithashtu SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme nga shkollat e tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera sipas disa procedurave dhe një dokumentacioni të kërkuar, kjo sipas rregullore sëe tranferimeve. (**<u>për vitin 2014</u>**, për shkak të mbylljes së disa Institucioneve të Arimit të Lartë me Vnedim të Këshillit të Ministrave, MAS ka përcaktuar rregulla të vacantë transferimi). Studenti që dëshiron të transferohet nga një shkollë tjetër universitare në UMB, duhet të paraqesë:

- kërkesën me shkrim drejtuar dekanit të fakultetit përkatës, ku të parashtrojë arsyet e transferimit dhe emrin e shkollës universitare nga e cila ka kërkuar të transferohet. Formulari i kërkesës për transferim merret në sekretarinë e fakultetit.
- vërtetimin a certifikatën e transferimit nga shkolla universitare.
- vërtetimin nga shkolla universitare për detyrimet e shlyera në atë shkollë me notat përkatëse dhe kreditet e fituara.
- një kopje të programeve të lëndëve të shlyera në shkollën universitare.
- një kopje (të noterizuar) të diplomës së shkollës së mesme.
- certifikatën e lindjes me fotografi.

UMB rezervon të drejtën t'i kërkojë zyrtarisht shkollës universitare "dërguese" një referencë me të dhënat mbi ecurinë dhe përparimin e studentit që dëshiron të transferohet.

- *Njohja e krediteve të transferimit:* Dokumentacioni i nevojshëm për transferim i përcillet departamentit që mbulon degën përkatëse. Ky i fundit, duke marrë edhe mendimin e departamenteve të tjera, kur është e nevojshme, bën vlerësimin e lëndëve sipas planeve dhe programeve mësimore të SHLUJ UMB, kryen transferimin e krediteve dhe vlerësimeve si dhe përcakton kursin dhe semestrin ku duhet të vijojë aplikanti dhe detyrimet plotësuese që ai do të duhet të shlyejë. Vlerësimi i përcillet dekanit të fakultetit.

- Mbështetur në këtë vlerësim dhe pasi është njohur edhe me referencën e shkollës "dërguese", dekani i fakultetit, brenda 15 ditëve, vendos lidhur me pranimin ose jo të kërkesës së studentit. Në rast pranimi, vendimi i përcillet rektorit, i cili urdhëron transferimin e studentit në SHLUJ UMB.
- Universiteti (nëpërmjet departamenteve) bazuar në dokumentacionin e paraqitur bën vlerësimin e lëndëve sipas planeve dhe programeve mësimore të SHLUJ UMB, kryen transferimin e krediteve dhe vlerësimeve si dhe përcakton kursin dhe semestrin ku duhet të vijojë aplikanti dhe detyrimet plotësuese që ai do të duhet të shlyejë.
- *Regjistrimi pas transferimit:* Me studentët e transferuar SHLUJ UMB lidh marrëveshje regjistrimi, e cila parashikon detyrimet e ndërsjella të palëve. Në emër të SHLUJ UMB marrëveshja e regjistrimit nënshkruhet nga kancelari i universitetit.

**Ripranimi**

- Për arsye vetjake ose familjare objektivisht të pranueshme studenti, me miratim, mundet t'i ndërpresë studimet në çdo kohë të vitit, për një afat jo më të gjatë se tre vjet, dhe mund t'i rifillojë ato. Për ndërprerjen e studimeve studenti është i detyruar, dhjetë ditë përpara, të njoftojë me shkrim dekanin e fakultetit. Për rifillimin e studimeve studenti është i detyruar, një muaj përpara, të njoftojë me shkrim dekanin e fakultetit.
- Kur studenti ndërpret studimet për arsye vetjake ose familjare objektivisht të pranueshme, kreditet e grumbulluara prej tij akumulohen dhe studenti ka të drejtë t'i rifillojë studimet edhe në atë periudhë të vitit akademik ku i ka ndërprerë.

**Tregues të matshëm:**

☑ Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

☑ Tabela 9.1 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

| Programi i studimit BSc në Administrim Biznesi | Studentë të regjistruar në vitin e parë (për herë të parë) | Nota Mesatare | Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse) | Nota Mesatare |
|---|---|---|---|---|
| 2011-2012 | 18 | 7.08 | 10 | 7.77 |
| 2012-2013 | 7 | 7.79 | - | 7.3 |
| 2013-2014 | 5 | 6.12 | - | 6.4 |
| Gjithsej | 30 | | | |

☑

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE | |
|---|---|
| Standardi IV.1<br>- Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj | |
| *Kriteri 1* Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. | Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në programin e ciklit të parë të studimit BA në Administrim Biznesi në SHLUJ P UMB, kryhet sipas udhëzimeve të MAS. (të cilat gjatë këtyre viteve kanë pësuar dhe ndryshime) |
| *Kriteri 2* Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të<br>cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve | SHLUJ UMB deklaron se për t`u pranuar në programin e studimit BA në Administrim Biznesi nuk aplikohen kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI IV.1 dhe KRITERET 1-2<br>SHLUJ UMB nuk aplikon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore për t`u pranuar në programin e studimit BA në Administrim Biznesi. Mënyra e organizimit të pritjes dhe informimit të të interesuarëve tregon se orintimi i tyre bëhet në mënyrë të tillë që të përshtaten sa më mirë me programet që ofron universiteti. | |
| Standardi IV.2<br>- Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit. | |
| *Kriteri 1* Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve; | Që në momentin e interesimit, studentët –prospekt informohen, por sigurisht deparatmenti dhe zyra e karrierës, si dhe çdo pedagog jep kontributin e tij në infomimin e studentëve. |
| *Kriteri 2* Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit; | SHLUJ UMB përdor pyetësorin e<br>studentit për vlerësimin e pedagogut të lëndës. (shih kopje të raporteve të vlerësimit dhe të pyetsorëve). |
| *Kriteri 3* Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës; | SHLUJ UMB ka një strukturë të posaçme "Zyra e Këshillimit dhe Karrierës"që ofron shërbimin e këshillimit për karrierën të studentëve.<br>Gjithashtu stukturat si Prorekori i Çështjeve studentore, Dekani i studentëve, Zyra e Aktiviteteve studentore, Alumni ofrojnë mbështetje për punësim të studentëve si gjatë studimeve dhe pas mbarimit. Nga të dhënat në lidhje me punësimin nga 10 studentë të diplomuar 6 prej tyre janë punësuar me kohë të plotë kryesisht në biznese private, ndërsa 4 të tjerët ndjekin studimet master shkencor dhe për këtë arsye nuk janë punësuar. |

| | |
|---|---|
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI IV.2 dhe KRITERET 1-3<br>SHLUJ UMB ka një strukturë të posaçme Zyra e Këshillimit dh e Karrierës që informon studentët në lidhje me programin e studimit, kohëzgjatjen dhe me politikat e punësimit. Po në funksion të tij objektivi janë dhe struktura të tjera si: Zyra Alumni, Dekani i studentëve, Zyra e Aktiviteteve studentore. | |
| Standardi IV.3<br>- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë. | |
| *Kriteri 1* Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë; | SHLUJ UMB ka statistika për numrin e të diplomuarëve. Këto të dhëna raportohen çdo vit pranë Drejtorisë së statistikave në MAS (ish MASH). Ndërkohë të dhënat e të diplomuarëve mbahen në regjistrin përkatës. (ky vit akademik p;rkon me diplominin e pare te studentëve të programit bachelor në Administrim Biznesi me 180 kredite). |
| *Kriteri 2* Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve | SHLUJ UMB mban statistika<br>vjetore të rregullta për numrin e të regjistruarve në programin e ciklit të parë të studimit.<br><br>Po kështu dhe në lidhje me transferimet, këto pasqyrohen dhe në tabelën 9.2. |
| *Kriteri 3* Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim. | SHLUP UMB disponon në formë elektronike dhe të shkruar, të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit studimor që nga pranimi deri në prag të diplomimit. (libri i notave) |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI IV.3 dhe KRITERET 1-3<br>SHLUJ UMB bazuar në dokumentacionet përkatëse që gjenden në sekretarinë mësimore disponon statistika vjetore në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të parë BA në Administrim Biznesi dhe për ecurinë e tyre që nga pranimi deri në diplomim. | |
| Standardi IV.4<br>- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve. | |
| *Kriteri 1* Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; | SHLUJ UMB ka ngritur një stukturë të veçantë për Këshillimin e Karrierës që ofron shërbimin e këshillimit studentëve. Progresi i tyre ndiqet dhe ndihmohet deparatamenti përkatës, i cili bashkëpunon me sekretarinë mësimore për të siguruar informacionin e nevojshëm. Krahas kësaj institutcioni ka ngritur sistemin e tutoriatit ku çdo grup mësimor ndiqet dhe asistohet nga nje pedagog. (bazuar në urdhrat e Rektorit për ngritjen dhe funksionimin e Tutoriatit). |
| *Kriteri 2* Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në | SHLUJ UMB ka marrëveshje me institucione të administratës publike, biznese private, etj në |

| | |
|---|---|
| përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë. | funksion të këtij qëllimi. |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI IV.4 dhe KRITERET 1-2<br>Pranë SHLUJ UMB funksionon një stukturë e veçantë për Këshillimin e Karrierës që ofron shërbimin e këshillimit studentëve. Krahas kësaj institutcioni ka ngritur sistemin e tutoriatit ku çdo grup mësimor ndiqet dhe asistohet nga nje pedagog. | |

**KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

## 10. Kërkimi shkencor në funksion të programit të studimit

**Pjesa përshkrimore**

SHLUP Universiteti Marin Barleti ka krijuar dhe qendra kërkimi, konkretisht funksionon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD) si dhe Institutin Shqiptar për Çështje Publike dhe Qendra e Trajnimit dhe Testimit Barleti BTTC, si dhe Instituti i Edukimit Barleti. Përvecse institucione akademike ato janë edhe institucione kërkimore-shkencore të cilët synojnë të jenë qendra të ekselencës për kërkimet ndërdisiplinore në fushat që lidhen me proceset sociale, ekonomike, aplikimeve të teknologjisë së informacionit dhe të mjedisit. Veçanërisht Institutet synojnë të realizojnë qëllimin e tyre nëpërmjet kryerjes së punës studimore e kërkimore, trajnimeve, kurseve e konsultave, shërbimeve, veprimtarisë botuese dhe realizimit të projekteve të nivelit të lartë në të mirë dhe interes të publikut. Ato kanë krijuar hap pas hapi të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të nxitur dhe mbështetur veprimtarinë kërkimore-shkencore ndërdisiplinore cilësore të strukturave të UMB-së, Intituteve, Qendrave dhe jashtë tyre si dhe për të mundësuar tek të gjithë të interesuarit zhvillimin e standardeve dhe përftimin e atyre njohurive, aftësive dhe kompetencave që i bëjnë eficientë, të sukseshëm dhe që u mundësojnë zhvillimin e karrierës. SHLUJ UMB, AIPA, BIRD BTTC dhe qendrat e tjera synojnë të bashkëpunojnë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhen pjesëmarrës aktiv në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit.

Si pjesë e strategjisë së tyre kërkimore, synojnë të arrijnë, përveç të tjerave, objektivat e meposhtëm**:**

- Hartojnë strategjitë kryesore të kërkimit dhe etikës në kërkim;
- Inkurajojnë krijimin e një gjenerate të re kërkuesish shkencor;
- Inkurajojnë partneritetin dhe integrimin e të rinjve në komunitet;
- Marrin pjesë në programet që financojnë projekte kërkimi nga donatorë të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit;
- Nxisin krijimin e një aleance të suksesshme midis aktorëve kryesorë në vend, për të mundësuar një dialog të vazhdueshëm midis;
- Sjellin më afër komunitetin e biznesit me botën akademike, ofrojnë konsulencë dhe shërbime të drejtpërdrejta për komunitetin e biznesit, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin e SME-ve, teknologjinë e informacionit, kërkimin, zhvillimin, inovacionin si dhe ekonominë e bazuar në dije;

Kërkimi shkencor është një nga drejtimet kryesore të SHLUJ UMB i cili realizohet në përputhje me kriteret dhe standartet e EQUIS, sipas kategorive të mëposhtme:

- Kërkimi akademik - i cili ka si qëllim prodhimin dhe organizimin e dijes, zhvillimin e teorive të reja dhe promovimin e forcimin e veprimtarive kërkimore në shërbim të mjedisit akademik, të bazuara në metodologji të reja e të mirëfillta shkencore;
- Kërkimi i orientuar drejt praktikës - kërkimi që prodhon dije të reja dhe që kontribuon nga ana e tij në përparimit e efektshëm të praktikës së menaxhimit.

- Zhvillimi dhe inovacioni pedagogjik - ka të bëjë me futjen dhe përdorimin e metodologjive pedagogjike, mjeteve të edukimit dhe materialeve e teknikave mësimore inovative.

Institutet dhe Qendrat janë njësi të angazhuar tërësisht në kërkimin që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të Universitetit por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tyre, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të Shqipërisë. Ato përpiqen që të ruajnë balancën në zhvillimin e trinomit arsim - kërkim - novacion, në përputhje me kriteret dhe standartet e BE-së. Një ndër objektivat kryesore të Universitetit, Instituteve dhe Qendrave është realizimi nëpërmjet stafit të brendshëm dhe atij të atashuar, i kërkimeve cilësore në fushat e veprimtarisë që mbulohen prej tyre, jo vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin, por edhe me institucione të tjera kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit. Vetë stafi akademik i Universitetit Marin Barleti realizon punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë qendrave, departamenteve apo Instituteve, si punonjës kryesorë kërkimor-shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektesh kërkimore.

**Studimet kërkimore shkencore në SHLUJ UMB kryhen, në veçanti, në fushat e mëposhtme:**
Studime mbi rolin dh eimpaktin e TI në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, studime mbi tregun e brendshëm, kohezionin social, sigurinë e ushqimit dhe konsumatorit;zhvillimin i qëndrueshëm;çështjet ekonomike dhe monetare; rininë, edukimin dhe formimin profesional;punësimin dhe çështjet sociale; ndërmarrjet; mjedisi; të drejtat e njeriut, marrëdhëniet institucionale;politikat dhe zhvillimet rajonale; zhvillimi rural

**Në të gjitha kategoritë tematike të sipërpërmendura, veprimtaria kërkimore - shkencore synon të:**

- trajtojë problemet kryesore që lidhen me interesat e drejtpërdrejta të të gjithë anëtarëve të shoqërisë;
- përdorë perspektivave ndërkombëtare krahasuese në edukim, duke zhvilluar vlerat e drejtësisë sociale, shanseve të barabarta dhe të mirën e përbashkët;
- kontribojë në reformat në sektorin publik, në kuptimin e marrëdhënieve dhe lidhjeve midis teorisë dhe praktikës në arsimim, duke e vënë theksin në mënyrë të veçantë tek lidhja midis edukimit dhe çështjeve sociale;
- rrisë standartin e kërkimit duke:
    - promovuar standartet më të larta në cilësinë e kërkimit si edhe integritetin etik në punën kërkimore;
    - orientuar kërkimin në të gjitha fushat dhe kategoritë;
    - përcjellë debatet publike për edukimin nëpërmjet kontributit të pavarur të mbështetur në punën kërkimore duke mirëpritur dhe mbështetur partneritetin me agjencitë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim që të promovojë të mirat publike në edukim;

Stafi akademik i SHLUJ UMB trajnohet në mënyrë të vazhdueshme dhe asistohet në realizimin e kualifikimeve brenda dhe jashtë institucionit, brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me zhvillimet e fundit mbi kërkimin shkencor si dhe teknologjinë e kërkimit. E gjithë veprimtaria kërkimore si dhe kualifikimet e stafit pasqyrohen dhe do të vazhdojnë të pasqyrohen në azhornimin në mënyrë të vazhdueshme të kurrikulave të UMB-së.

Institutet dhe Qendrat mundësojnë formimin dhe trajnimin e studentëve të SHLUJ UMB nëpërmjet kurseve dhe moduleve të ofruara në fushat e veprimtarisë së qendrave kërkimore-shkencore te tij dhe strukturave të tjera të SHLUJ UMB. Gjithashtu studentët azhornohen me kërkimet më të fundit të realizuara nga SHLUJ UMB dhe Institutet nëpërmjet aktiviteteve të organizuara brenda dhe jashtë kampusit si dhe botimeve të ndryshme të cilët do të pasqyrojnë rezultatet e punës kërkimore.

Puna kërkimore-shkencore nxitet tek studentët e nivelit të parë, duke u bërë pjesë e integruar e formimit të tyre akademik brenda SHLUJ UMB. Angazhimi në projektet e kërkimit dhe përgatitja e tezave në perfundim të studimeve Bachelor dhe Master, i aftëson ata për të qenë më të pavarur në gjetjen e zgjidhjeve dhe përballimin e kërkesave të një ekonomie inovative.

Universiteti, Institutet dhe Qendrat ofrojnë për studentët e të gjitha niveleve informacione për mundësitë që ofrohen për kualifikimin e tyre nga universitete dhe qendra të tjera kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe t'i mbështesë ata në procesin e aplikimit.

Një ndër bashkëpunimet e frytshme më të fundit të Fakultetit ka qene ai me kompanine DIAVA dhe Fakultetin e Shkencave te Natyres ne pergatitjen e Strategjise Kombetare te Biodiversitetit“, bashkepunimi me “Center for Sustainable Tourism“ – Mali i Zi ne projektin „Art- Plastic and Recycling“ dhe aplikimin “Greening the Apps“. Bashkepunim i sukseshem ka qene edhe bashekpunimi me USAID ne projektin“ Certifikimi i Experteve te Turizmit“ nga Instituti Arsimor Amerikan per Hoteleri- Turizem (AHLEI) o

**PUBLIKIME :** Studimet dhe hulumtimi i zhvilluar nga stafi akademik i Universitetit publikohen periodikisht në revistën "Gjeopolitika" si dhe në revista të tjera të njohura ndërkombëtarisht. Revista "Gjeopolitika" publikohet një herë në tre muaj duke u fokusuar në çështje tematike të rëndësisë bashkëkohore. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" është në proces të përgatitjes së një reviste tjetër shkencore që do të mbulojë fushat kryesore të veprimtarisë shkencore në SHLUJ UMB dhe do të sjellë përfitime për akademikë dhe shkencëtarë, universitete dhe institucione kërkimore, donatorë dhe kërkues të pavarur në Shqipëri dhe Rajon, duke u bërë një lider në këtë drejtim.

**Tregues të matshëm:**

Tabela 10.1: Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit

| Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit | | |
|---|---|---|
| 1. | Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL | 10 |
| 2. | Numri i projekteve kërkimore të fituara | 4 |
| 3. | Numri i projekteve të zbatuara | 6 |
| 4. | Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit | 4 |
| 5. | Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL | Rreth 300 |
| 6. | Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor | 0 |
| 7. | Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor | 15 |
| 8. | Numri i Çmimeve Kombëtare | 0 |

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

Në SHLUJ Universiteti "Marin Barleti", angazhimi akademik është i lidhur ngushtë me bashkëpunimin ndërkombëtar. Ndërkombëtarizimi i Universitetit dhe i Studentëve është edhe në funksion e akreditimit ndërkombëtar të Universitetit. SHLUJ "Universiteti Marin Barleti" ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

**Marrëveshje me këto universitete:**

- Universiteti " Universum", Kosovë,15 Prill 2007
- Universiteti për Biznes dhe Tekonlogji,Prishtinë, Kosovë, 7 Mars 2008
- Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni, 7 Mars 2008
- Universiteti "Fama", Kosovë, 12 Janar 2009
- Universiteti Clemson,South Caroline, USA, 8 Mars 2010
- Universiteti Ibero-American (UNIBE), Rep.Domenikane, 8 Mars 2010
- Universiteti "Mahidol", Tailand, 8 Mars 2010
- Universiteti i Prishtines, Kosove,8 Mars 2010
- Universiteti "South Bohemia" , Rep. Çeke,8 Mars 2010
- Universiteti "Free State", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010
- Universiteti "Western Cape", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010
- Universiteti "Tallin", Estoni, 8 Mars 2010
- Universiteti Capital Normal, 14 Prill 2010
- Universiteti Cardiff, England,5 Maj 2010
- Universiteti i Udine-s, Fakulteti i Ekonomisë,Itali,22 Qershor 2010
- Kolegji Bournville, Birmingham Mbretëri e bashkuar, 22 Qershor 2011
- Politekniku i Barit (POLIBA), Itali, 31 Janar 2013
- Universiteti i Barit, Itali, 31 Mars 2013
- Universiteti i Arkansasit, Clinton School, 3 Prill 2013
- Universiteti Roma Tre, Itali, 26.Qershor 2013
- Universiteti i Teknologjisë Lappeenranta, Finland, 01 Gusht 2013
- Instituti Teknologjik i Epirit, 1 .Maj 2014
- Universiteti i Genovas, Itali, 13 Janar 2015
- Universiteti i Salentos, Itali, 26 Shkurt 2015

**Marrëveshje me universitetet e rajonit**

- Memorandum bashkëpunimi me Universitetin AAB Prishtinë
- Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tetovës
- Universitetin për Biznes dhe Teknologji, të Prishtinës (UBT)
- Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Dardania në Prishtinë.
- Instituti Evropian për Studime Juridike "Juridica"
- Universiteti Mbretëror "Iliria", Prishtinë
- Kolegji Evropian i Prishtinës
- Kolegji Internacional Prizren

Po kështu ka Memorandume bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë në Tiranë dhe Durrës, Memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Inovacionit, të Kulturës dhe atë për Çështjet Vendore si dhe Administratën Publike; gjithashtu janë nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi më disa nga agjencitë e rëndësishme të

punësimit si ANDE - LM dhe "duapunë.com"ku synimi kryesor i këtyre marrëveshjeve është pozicionimi i studentëve në tregun e punës. (referojuni marrëveshjeve)

**Tregues të matshëm:**

Tabela 11.1: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Fakulteti i Shkencave te Aplikuara, si pjese e SHLP "Universiteti Marin Barleti" është një institucion i institucion i karakterizuar nga një dimensioni i spikatur ndërkombëtar, gjë që reflektohet në programet e studimit, përbërjen e stafit akademik, studentët por dhe në shkëmbimet intensive dhe të larmishme me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë si në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore e didaktike ashtu dhe në shkëmbime të vazhdueshme dhe mobilitet të lartë mes stafit akademik dhe studentëve. Vëmendje të vecantë i kushtohet gjithashtu zgjerimit të rrjetit të partneriteteve jo vetëm me institucione ndërkombëtare e lokale të sektorit të arsimit, por dhe me aktorë të ndryshëm nga komuniteti i biznesit, organizmat qeveritare dhe joqeveritare, shoqata dhe organizata profesionale, etj.

Të dhëna të matshme për sa më sipër gjenden në tabelat më poshtë.

Tabela 11.1: Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

| **Aktivitete shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit** | | |
|---|---|---|
| 1 | Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare | 7 |
| 2 | Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj | 8 |
| 3 | Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit | 4 |
| 4 | Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit | 8 |
| 5 | Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor | 3 laboratorë, 1 qendër testimi |
| 6 | Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime | 15 |
| 7 | Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor. | - |

Tabela 11.2.: Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

| **Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese** | |
|---|---|
| 1. Institucionet bashkëpunuese ne nivel IAL: | Lloji i bashkëpunimit |
| American Hotel and Lodging Education Institute | Programi i përbashkët ne Hoteleri Turizem |
| Center for Sustainable Tourism Development-Montenegro | Partnere ne projektin: "Art, Plastic and Recycling" |
| University of L'Aquila, Department of Medicine, Health, Life and Environment- Italy | Partnere ne projekt-propozimin "Development and application of hydro-geochemical and biological indicators in sustainable management of coastal and karstic aquifers in Adriatic region" |
| Geological Survey of Slovenia- Slovenia | Partnere ne projekt-propozimin e lart-permendur |
| Jožef Stefan Institute, Department of Environmental Sciences- Slovenia | Partnere ne projekt-propozimin e lart-permendur |
| Ruđer Bošković Institute, Centre for Marine and Environmental Research- Croatia | Partnere ne projekt-propozimin e lart-permendur |
| Center for Eco-toxicological Research -Montenegro | Partnere ne projekt-propozimin e lart-permendur |
| Hydro-Engineering Institute of Civil Engineering Faculty Sarajevo- Bosnia and Herzegovina | Partnere ne projekt-propozimin e lart-permendur |
| 2. Institucionet qeveritare bashkëpunuese | |
| Ministria e Integrimit Europian | - Shkëmbimi njohurive dhe kapaciteteve<br>- Projekti "Art, Plastic and Recycling"ne kuader te IPA cross-border: Shqiperi Mali i Zi |
| Ministria e Mjedisit | - Shkëmbimi njohurive dhe kapaciteteve<br>- Projekti "Preparation of National Biodiversity Strategy and Action Plan 2013-2020" |
| Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta | - Ofrimi i kurseve afta-shkurtra te trainimit<br>- Shkëmbim i njohurive dhe kapaciteteve |
| Ministria e Turizmit dhe Zhvillimit Urban | - Ofrimi i kurseve te trainimit ne Hoteleri - Turizem<br>- Organizim Konferencash dhe forumesh mbi Turizmin, dhe trashegimine arkitekturore<br>- Bashkepunim nepermjet Institutit Adriapol<br>- Smart and Creative Development<br>- Shkëmbim i njohurive dhe kapaciteteve |
| Bashkite Krujë dhe Fushe –Kruje | Projekti "Soft Skills pertej Njohurive Akademike" |
| USAID | Projekti "Capacity building and Certification for Hospitality Educators at Marin Barleti Univeristy" |
| 3. Komuniteti i biznesit, tregu i punës | |

| | |
|---|---|
| Diava Consulting | Partnere ne Projektin ”Preparation of National Biodiversity Strategy and Action Plan 2013-2020” |
| Marketing and Distribution | Praktika per studenetet |

**Vlerësimi sipas Standardeve**

| VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME | |
|---|---|
| **Standardi VII.1**<br>**- Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.** | |
| *Kriteri 1* Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; | Ndryshimet në programe bëhen me një pjesmarrje të gjerë të departamenteve, dhe stafeve të jashtëm me përvojë në fushën e drejtësisë. |
| *Kriteri 2* Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. | Fakulteti Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë organizon takime formale dhe jo formale me anëtarët e departamenteve pjesë e së cilës janë dhe analizat. Por, referuar raporteve vjetore të vëna në dispozicion nga rektori rezulton se SHLUJ UMB organizon takime e analiza për aspekte të ndryshme duke garantuar bashkëpunimin e anëtarëve të stafit (shih analizat vjetore, të punës kërkimore, të vlerësimit të brendshëm). |
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI VII.1 dhe KRITERET 1-2<br>Për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, SHLUJ UMB nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe siguron një përfshirje më të gjerë. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë organizon takime formale dhe jo formale me anëtarët e departamenteve pjesë e së cilës janë dhe analizat. SHLUJ UMB organizon takime e analiza për aspekte të ndryshme duke garantuar bashkëpunimin e anëatarëve të stafit. | |
| Standardi VII.2<br>- Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. | |
| *Kriteri 1* Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj; | SHLUJ UMB për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.<br><br>**Marrëveshje me këto universitete:**<br>• Universiteti " Universum", Kosovë,15 Prill 2007<br>• Universiteti për Biznes dhe Tekonlogji,Prishtinë, Kosovë, 7 Mars 2008<br>• Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni, 7 Mars 2008<br>• Universiteti "Fama", Kosovë, 12 Janar 2009<br>• Universiteti Clemson,South Caroline, USA, 8 Mars 2010<br>• Universiteti Ibero-American (UNIBE), |

| | |
|---|---|
| | Rep.Domenikane, 8 Mars 2010<br>• Universiteti "Mahidol", Tailand, 8 Mars 2010<br>• Universiteti i Prishtines, Kosove,8 Mars 2010<br>• Universiteti "South Bohemia" , Rep. Çeke,8 Mars 2010<br>• Universiteti "Free State", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010<br>• Universiteti "Western Cape", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010<br>• Universiteti "Tallin", Estoni, 8 Mars 2010<br>• Universiteti Capital Normal, 14 Prill 2010<br>• Universiteti Cardiff, England,5 Maj 2010<br>• Universiteti i Udine-s, Fakulteti i Ekonomisë,Itali,22 Qershor 2010<br>• Kolegji Bournville, Birmingham Mbretëri e bashkuar, 22 Qershor 2011<br>• Politekniku i Barit (POLIBA), Itali, 31 Janar 2013<br>• Universiteti i Barit, Itali, 31 Mars 2013<br>• Universiteti i Arkansasit, Clinton School, 3 Prill 2013<br>• Universiteti Roma Tre, Itali, 26.Qershor 2013<br>• Universiteti i Teknologjisë Lappeenranta, Finland, 01 Gusht 2013<br>• Instituti Teknologjik i Epirit, 1 .Maj 2014<br>• Universiteti i Genovas, Itali, 13 Janar 2015<br>• Universiteti i Salentos, Itali, 26 Shkurt 2015<br><br>**Marrëveshje me universitetet e rajonit**<br>• Memorandum bashkëpunimi me Universitetin AAB Prishtinë<br>• Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tetovës<br>• Universitetin për Biznes dhe Teknologji, të Prishtinës (UBT)<br>• Memorandum bashkëpunimi me Universitetin Dardania në Prishtinë.<br>• Instituti Evropian për Studime Juridike "Juridica"<br>• Universiteti Mbretëror "Iliria", Prishtinë<br>• Kolegji Evropian i Prishtinës<br>• Kolegji Internacional Prizren. |
| Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë; | SHLUJ UMB ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron. Kjo dëshmohet me dokumentet e marrëveshjeve të bashkëpunimit. |
| *Kriteri 3* Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; | SHLUJ UMB ka shfrytezuar veçanërisht stafin akademik të huaj për realizimin e këtyre trajnimeve. |

| | |
|---|---|
| *Kriteri 4* Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Institucioni ka bërë raporte analitike për ecurinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit. |

| |
|---|
| Komente përmbledhëse në lidhje me plotësimin e STANDARDI VII.3 dhe KRITERET 1-2<br><br>SHLUJ UMB për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. Instituci ka bërë pjesë të analizave të tij dhe ecurinë e këtyre marrëveshjeve. |

# IV. ANALIZA SWOT

## a. Pika të forta:

- Funksioni SHLUJ UMB dhe programi BA në Administrim biznesi mbështeten në një vizion të mirë përcaktuar, mision dhe plan të zhvillimit strategjik të qartë, të plotë, bashkëkohor. Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit të institucionit është një dokument që orienton drejt dhe me realizëm zhvillimin në kontekstin e institucionit, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

- Programi BA në Administrim Biznesi është i një cilësie të lartë. Programi garanton përgatitjen e studentëve në përputhje me objektivat e përcaktuar. Programi është ndërtuar në përputhje me vizionin, misionin e institucionit, nevojat e tregut, objektivat e reformës së arsimit të lartë në vend dhe të Procesit të Bolonjës dhe ka të integruar përvojën më të mirë bashkëkohore të huaj dhe vendase.

- Respektimi i standardeve akademike. Programet e studimit respektojnë standardet akademike. Plani mësimor, syllabuset metodat e mësimdhënies e mësimnxënies janë sipas kërkesave të standardeve akademike.

- Integrim i mësimit me kërkimin i cili realizohet si në nivelin instucional, të programit individual të pedagogëve dhe të studentëve.

- Ofertë sipas kërkesave të tregut. Programi është përshtatur sipas interesave të studentëve dhe që garanton konkurrimin në tregun e punës.

- Personel akademik me tituj dhe eksperiencë domethënëse në fushën e Administrimti dhe biznesit. Ky tregues garanton një cilësi të lartë të mësimdhënies.

- Infrastruktura moderne dhe funksionale. Ky është një tregues që ndihmon realizimin me efektivitet të programit.

- Bashkëpunim i institucionalizuar më institucione homologe dhe institucione, ndërmarrje. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi SHLUJ UMB realizon objektivat për kërkimin, shkëmbimin e eksperiancave dhe punësimin e të diplomuarve.

- Hartimi dhe përdorimi i një dokumentacioni ligjor dhe pedagogjik në nivelin e institucionit dhe të programit (Statuti i SHLUJ UMB, Rregullorja e SHLUJ UMB, Rregullorja për Regjistrimin, Rregullorja për Transferimin e Studentëve, Politika e Vlerësimit të Brendshëm, Rregullorjat e Programit BA në Drejtësi, Planet mësimore, Programet lëndore, etj). Ky tregues dëshmon për një veprimtari të institucionalizuar, të strukturuar dhe të standardizuar.

- Baza e të dhënave për studentët dhe personelin akademik. Zotërimi i të dhëna të regjistruara dhe përdorimi elektronik i tyre ka krijuar avantazhe për të mbajtur në shumë të dhëna, për t'i organizuar ato në mënyra të ndryshme, për t'i përdorur më lehtësisht nga të interesuarit.

- Strukturë e kompletuar organizative dhe funksionale. Krijimi i një strukture të kompletuar, i njësive koordinuese dhe sigurimit të cilësisë kanë ndihmuar në një menaxhim më të efektshëm, delegim të detyrave dhe përmbushje më të mirë.

**b. Pika të dobëta:**

- Numri i studentëve jo në nivele të kërkuara dhe të planifikuara apo sipas pritshmërive të kërkuara. Ka ndikuar këtu dhe ofrimi i programeve të ngjashme nga SHLUJ UMB duke bërë si të thuash një farë konkurrence brenda vetes.

**c. Mundësitë:**

- Eksperienca e fituar në projekte rrit mundësitë për të aplikuar dhe bërë pjesë e projekteve të reja duke përfshirë gjithnjë e më shumë studentët.

**d.Pengesat:** Nuk konstatohen.

Në përfundim të vlerësimit të përmbushjes së standardeve shtëtërore të cilësisë për programet e ciklit të parë të studimeve, GVB arrin në përfundimin se programi BA në Administrim Biznesi që ofron SHLUJ UMB i plotëson kriteret e cilësisë.

**Grupi i Vlerësimit të Brendshëm**

1. Semiha Loca
2. Jorida TARAJ
3. Andi Gjokutaj
4. Kleopatra Puraveli
5. Desara Doçi
6. Mirjan Petro

Aneksi I: Lista e Licencave, vendimet e akreditimit

Aneksi II: Planimetritë e SHLUJ Universiteti Marin Barleti

Në CD, Programi, Rregullore programi, Përligjja e Programit, syllabuset e lëndëve.